



KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. ____/2026

PËR

PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT

“PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE TË RREZIKSHME”

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Propozimin e projektligjit “Për transportin e mallrave të rrezikshme”, për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit dhe relacionit që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

**MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

Enea Karakaçi



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

PROJEKT LIGJ

Nr. ____/2026

“PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE TË RREZIKSHME”¹

Në mbështetje të neneve 78, dhe 81, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim garantimin e transportit të sigurt të mallrave të rrezikshme me rrugë dhe me hekurudhë, si dhe parandalimin dhe kufizimin e rreziqeve që mund të lindin gjatë këtij transporti për jetën dhe shëndetin e njerëzve, pronën dhe mjedisin.

**Neni 2
Objekti**

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për kryerjen e transportit rrugor dhe hekurudhor të mallrave të rrezikshme, kompetencave të autoriteteve përgjegjëse dhe detyrimeve të pjesëmarrësve në transport, si dhe i kushteve për autorizimin, trajnimin, certifikimin, ambalazhimin, përdorimin e cisternave, pajisjeve, mjeteve rrugore dhe vagonëve, kontrollin, raportimin dhe masat që zbatohen në rast shkeljeje.

**Neni 3
Fusha e zbatimit**

1. Ky ligj zbatohet për transportin rrugor dhe hekurudhor të mallrave të rrezikshme:
 - a) brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - b) nga territori i një shteti tjetër drejt territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - c) nga territori i Republikës së Shqipërisë drejt territorit të një shteti tjetër;
 - ç) në transit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Ky ligj zbatohet edhe për veprimtaritë e lidhura drejtpërdrejt me transportin e mallrave të rrezikshme, përfshirë ngarkimin, shkarkimin, transferimin nga ose drejt një mënyre tjetër transporti

¹Ky ligj është përafshuar:

Plotësisht me Direktivën 2008/68/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 24 shtator 2008, “Mbi transportin tokësor të mallrave të rrezikshme”, CELEX 32008L0068, botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian, seria L 260, datë 30.9.2008, fq. 13–59, siç është ndryshuar.

Pjesërisht me Direktivën (BE) 2022/1999 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 19 tetor 2022, “Mbi procedurat uniforme për kontrollet në transportin rrugor të mallrave të rrezikshme”, CELEX 32022L1999, botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian, seria L 274, datë 24.10.2022, fq. 1–13, siç është ndryshuar.

dhe ndalesat e nevojshme për shkak të rrethanave të transportit, për aq sa këto veprimtari lidhen me transportin rrugor ose hekurudhor të mallrave të rrezikshme.

3. Ky ligj nuk zbatohet për transportin e mallrave të rrezikshme:

a) me mjete rrugore ose vagonë që u përkasin ose janë nën përgjegjësinë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe forcave të armatosura të shteteve të tjera, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare në fuqi;

b) tërësisht brenda perimetrit të një zone të mbyllur.

4. Në Republikën e Shqipërisë nuk lejohet transporti i mallrave të rrezikshme në rrugë ujore të brendshme.

Neni 4 **Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “ADR” është Marrëveshja Evropiane për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme, e lidhur në Gjenevë, më 30 shtator 1957, së bashku me anekset A dhe B të saj, siç është ndryshuar, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr. 9272, datë 16.9.2004, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen Evropiane për Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme (ADR)”.
2. “Certifikatë e trajnimit të drejtuesit të mjetit sipas ADR-së” është dokumenti që vërteton aftësinë profesionale të drejtuesit të mjetit rrugor për transportin rrugor të mallrave të rrezikshme, në përputhje me ADR-në dhe këtë ligj.
3. “Certifikatë e këshilltarit të sigurisë” është dokumenti që vërteton aftësinë profesionale të personit për të ushtruar funksionet e këshilltarit të sigurisë për transportin e mallrave të rrezikshme, në përputhje me ADR-në ose RID-in.
4. “Certifikatë e miratimit ADR për mjetin rrugor” është certifikata e miratimit e parashikuar në ADR, që vërteton se mjeti rrugor i destinuar për transportin e mallrave të caktuara të rrezikshme plotëson kërkesat teknike përkatëse.
5. “Dërgues”, “transportues”, “marrës”, “ambalazhues”, “ngarkues”, “mbushës” dhe “shkarkues” kanë kuptimin e dhënë përkatësisht në ADR ose RID.
6. “Këshilltar i sigurisë” është personi i caktuar nga pjesëmarrësi në transport për të kryer detyrat e këshilltarit të sigurisë për transportin e mallrave të rrezikshme, në përputhje me ADR-në, RID-in dhe këtë ligj.
7. “Mallra të rrezikshme” janë substancat dhe artikujt, transporti i të cilëve me rrugë ose me hekurudhë është i ndaluar ose lejohet vetëm në kushtet e përcaktuara në ADR ose RID.
8. “Ministria përgjegjëse për transportin” është ministria që mbulon fushën e transportit.
9. “Mjet rrugor” është çdo mjet motorik i destinuar për përdorim në rrugë, që ka të paktën katër rrota dhe shpejtësi maksimale të projektuar mbi 25 km/orë, si dhe çdo rimorkio, me përjashtim të mjeteve që lëvizin mbi shina, makinerive të lëvizshme dhe traktorëve bujqësorë ose pyjorë që, gjatë transportit të mallrave të rrezikshme, nuk lëvizin me shpejtësi mbi 40 km/orë.
10. “Organ i miratuar” ka kuptimin e përcaktuar në legjislacionin në fuqi për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit dhe ushtron funksionet përkatëse kur kjo kërkohet sipas ADR-së, RID-it ose legjislacionit të posaçëm në fuqi.
11. “Pajisje e transportueshme nën presion” ka kuptimin e përcaktuar në legjislacionin e posaçëm në fuqi për pajisjet e transportueshme nën presion dhe, sipas rastit, në ADR ose RID.
12. “Pjesëmarrës në transport”, është çdo person fizik ose juridik që merr pjesë në transportin e mallrave të rrezikshme ose në veprimtaritë e lidhura drejtpërdrejt me të, përfshirë dërguesin, transportuesin, marrësin, ngarkuesin, shkarkuesin, ambalazhuesin, mbushësin, operatorin e cisternës dhe çdo pjesëmarrës tjetër të përcaktuar në ADR ose RID.
13. “RID” është Rregullorja për transportin ndërkombëtar hekurudhor të mallrave të rrezikshme, që përbën Shtojcën C të Konventës për Transportin Ndërkombëtar Hekurudhor (COTIF), e lidhur në Vilnius, më 3 qershor 1999, siç është ndryshuar, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar nëpërmjet ligjit nr. 8638, datë 13.7.2000, “Për aderimin në Protokollin e Vilniusit të 3 qershorit 1999, që përmban modifikimin e Konventës për Transportet Ndërkombëtare Hekurudhore (COTIF), të 9 majit 1980”.

14. “Struktura përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme” është struktura pranë ministrisë përgjegjëse për transportin, e ngarkuar me funksione teknike, bashkërenduese, raportuese dhe administruese të të dhënave për zbatimin e këtij ligji, ADR-së dhe RID-it.
15. “Transport i mallrave të rrezikshme” është transporti rrugor ose hekurudhor i mallrave të rrezikshme, i kryer tërësisht ose pjesërisht brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, përfshirë veprimtaritë e lidhura drejtpërdrejt me këtë transport sipas nenit 3 të këtij ligji.
16. “Vagon” është çdo mjet hekurudhor pa fuqi vetëlëvizëse, që lëviz mbi rrotat e veta në shina hekurudhore dhe përdoret për transportin e mallrave.
17. Termat teknikë dhe shprehjet e tjera të përdorura në këtë ligj, që nuk përkufizohen shprehimisht në këtë nen, kanë kuptimin e përcaktuar në ADR ose RID, përveç rasteve kur ky ligj parashikon ndryshe.

Neni 5

Zbatimi, përditësimi dhe publikimi i ADR-së dhe RID-it

1. Transporti i mallrave të rrezikshme me rrugë ose me hekurudhë lejohet vetëm kur kryhet në kushtet e përcaktuara përkatësisht në ADR, së bashku me anekset A dhe B të saj, ose në RID, si Shtojca C e Konventës për Transportin Ndërkombëtar Hekurudhor (COTIF), pa cenuar rregullat e përgjithshme për hyrjen në treg dhe rregullat e përgjithshme të zbatueshme për transportin e mallrave.
2. Në përjashtim nga pika 1 e këtij neni dhe vetëm në rastet e parashikuara në nenin 47 të këtij ligji, mund të autorizohet kryerja e një operacioni të caktuar transporti të mallrave të rrezikshme që është i ndaluar sipas ADR-së ose RID-it, ose kryerja e tij në kushte të ndryshme nga ato të përcaktuara në ADR ose RID.
3. Transporti i mallrave të rrezikshme nga ose drejt një shteti tjetër lejohet kur përputhet me kërkesat përkatëse të ADR-së ose RID-it, përveç kur në ADR ose RID parashikohet ndryshe.
4. Për operacionet e transportit të mallrave të rrezikshme që kryhen tërësisht brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, dokumentet dhe informacionet që shoqërojnë transportin, sipas ADR-së ose RID-it, mund të jenë edhe në gjuhën angleze. Autoriteti kompetent mund të kërkojë përkthimin në gjuhën shqipe kur kjo është e nevojshme për kontrollin, verifikimin ose sigurinë e transportit.
5. Ndryshimet dhe përditësimet e ADR-së dhe RID-it ndiqen nga ministria përgjegjëse për transportin dhe zbatohen në Republikën e Shqipërisë në përputhje me procedurat e parashikuara në ADR dhe RID, si dhe me legjislacionin në fuqi për marrëveshjet ndërkombëtare.
6. Ministria përgjegjëse për transportin publikon në faqen e saj zyrtare informacionin për versionin e përditësuar të zbatueshëm të ADR-së dhe RID-it, lidhjet elektronike me tekstet autentike ose të konsoliduara dhe tekstin informues në gjuhën shqipe.

KREU II

AUTORITETET KOMPETENTE DHE BASHKËRENDIMI INSTITUCIONAL

Neni 6

Autoritetet kompetente

1. Autoritetet kompetente për zbatimin e këtij ligji, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, janë:
 - a) ministria përgjegjëse për transportin;
 - b) struktura përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme pranë ministrisë përgjegjëse për transportin;
 - c) Policia e Shtetit, nëpërmjet strukturave të Policisë Rrugore;
 - ç) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (në vijim “DPSHTRR”);
 - d) Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore;
 - e) autoritetet doganore;
 - ë) Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial dhe autoritetet e mbikëqyrjes së tregut, sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi për pajisjet e transportueshme nën presion;
 - f) autoritetet përgjegjëse për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe sigurinë bërthamore;
 - g) autoriteti përgjegjës për lëndët plasëse për përdorim civil.

2. Autoritetet e tjera publike bashkëpunojnë me autoritetet kompetente të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni dhe ushtrojnë funksionet e tyre sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi, kur kjo është e nevojshme për zbatimin e këtij ligji.

Neni 7

Ministria përgjegjëse për transportin

1. Ministria përgjegjëse për transportin është institucioni përgjegjës për politikën, kuadrin ligjor dhe bashkërendimin e përgjithshëm në fushën e transportit rrugor dhe hekurudhor të mallrave të rrezikshme.

2. Ministria përgjegjëse për transportin kryen këto detyra:

- a) përgatit ose propozon projektakte ligjore dhe nënligjore në fushën e transportit të mallrave të rrezikshme;
- b) ndjek përafrimin e kuadrit kombëtar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, ADR-në dhe RID-in;
- c) bashkërendon punën ndërmjet autoriteteve kompetente për zbatimin e këtij ligji;
- ç) miraton raportimet kombëtare në fushën e transportit të mallrave të rrezikshme, kur këto kërkohen sipas këtij ligji;
- d) kryen komunikimin zyrtar me institucionet e Bashkimit Evropian, me organizatat ndërkombëtare dhe me autoritetet kompetente të shteteve të tjera, kur ky komunikim kërkohet sipas marrëveshjeve ndërkombëtare në fuqi ose detyrimeve të zbatueshme në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Neni 8

Struktura përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme

1. Pranë ministrisë përgjegjëse për transportin funksionon struktura përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme, si strukturë teknike dhe bashkërenduese për ndjekjen e zbatimit të këtij ligji.

2. Struktura përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme kryen këto detyra:

- a) administron listën e autoriteteve kompetente dhe të pikave të kontaktit për transportin e mallrave të rrezikshme;
- b) mbledh, administron dhe përpunon të dhënat që i përcillen nga autoritetet kompetente për zbatimin e këtij ligji;
- c) përgatit informacionin teknik për raportimet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e transportit të mallrave të rrezikshme;
- ç) bashkërendon shkëmbimin teknik të informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente;
- d) administron të dhënat që i përcillen nga autoritetet kompetente për kontrollin e kryera, shkeljet e konstatuara dhe masat administrative ose sanksionet e vendosura në zbatim të këtij ligji;
- dh) përgatit informacionin teknik të nevojshëm për komunikimin e ministrisë përgjegjëse për transportin me institucionet e Bashkimit Evropian, organizatat ndërkombëtare dhe autoritetet kompetente të shteteve të tjera;
- e) ndjek ndryshimet e ADR-së, RID-it dhe legjislacionit të Bashkimit Evropian në fushën e transportit të mallrave të rrezikshme dhe i paraqet ministrisë përgjegjëse për transportin informacionin teknik përkatës.

Neni 9

Policia e Shtetit

1. Policia e Shtetit, nëpërmjet strukturave të Policisë Rrugore, ushtron kontrollin në rrugë të transportit të mallrave të rrezikshme dhe merr masat e sigurisë gjatë transportit rrugor, në përputhje me këtë ligj, ADR-në dhe Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë.

2. Policia Rrugore kryen këto detyra:

- a) kontrollon në rrugë transportin e mallrave të rrezikshme;
- b) verifikon dokumentet e transportit, certifikatat, autorizimet, pajisjet, shënimet, etiketat, pllakat-etiketa, panelet portokalli dhe elementet e tjera të kërkuara sipas ADR-së dhe këtij ligji;
- c) përdor listën e kontrollit për transportin rrugor të mallrave të rrezikshme;

ç) urdhëron ndalimin, pezullimin, kufizimin ose ndërprerjen e transportit, kur shkelja ose gjendja e transportit cenon sigurinë;

d) përcakton, kur është e nevojshme, vendin e sigurt për ndalimin, parkimin ose mbajtjen e përkohshme të mjetit që transporton mallra të rrezikshme;

dh) njofton autoritetet e tjera kompetente në rast aksidenti, incidenti, rrjedhjeje, derdhjeje, humbjeje ose rreziku të menjëhershëm gjatë transportit rrugor të mallrave të rrezikshme;

e) i përcjell strukturës përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme të dhënat për kontrollet e kryera, shkeljet e konstatuara dhe masat e marra.

Neni 10

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor

1. DPSHTRR-ja ushtron funksione administrative dhe teknike në lidhje me drejtuesit e mjeteve, mjetet rrugore, certifikatat dhe regjistrat që lidhen me transportin rrugor të mallrave të rrezikshme.

2. DPSHTRR-ja kryen këto detyra:

a) administron të dhënat për drejtuesit e mjeteve rrugore që transportojnë mallra të rrezikshme, për certifikatat e trajnimit të drejtuesve të mjeteve, si dhe për certifikatat e këshilltarëve të sigurisë për transportin rrugor të mallrave të rrezikshme sipas ADR-së;

b) administron të dhënat për mjetet rrugore dhe certifikatat e miratimit ADR, për aq sa këto të dhëna lidhen me funksionet e saj;

c) siguron shkëmbimin e të dhënave me Policinë Rrugore, strukturën përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme dhe autoritetet e tjera kompetente;

ç) i përcjell strukturës përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme të dhënat e nevojshme për raportim dhe monitorim;

d) kryen veprimet administrative për lëshimin, rinovimin, pezullimin, revokimin, zëvendësimin dhe administrimin e dokumenteve dhe certifikatave që ka në kompetencë, sipas këtij ligji dhe legjislacionit të posaçëm në fuqi.

Neni 11

Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore

1. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore ushtron funksionet që lidhen me sigurinë hekurudhore dhe mbikëqyrjen e transportit hekurudhor të mallrave të rrezikshme, në përputhje me legjislacionin e posaçëm në fuqi, RID-in dhe këtë ligj.

2. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore kryen këto detyra:

a) mbikëqyr zbatimin e kërkesave të RID-it në transportin hekurudhor të mallrave të rrezikshme;

b) kontrollon transportin hekurudhor të mallrave të rrezikshme, sipas fushës së tij të përgjegjësisë;

c) kërkon nga sipërmarrësit hekurudhorë, administruesit e infrastrukturës dhe pjesëmarrësit e tjerë në transport informacionin dhe dokumentet e nevojshme për kontrollin dhe mbikëqyrjen;

ç) merr masat administrative që i takojnë sipas këtij ligji dhe legjislacionit për sigurinë hekurudhore;

d) lëshon, rinovon, pezullon dhe revokon certifikatën e këshilltarit të sigurisë për transportin hekurudhor të mallrave të rrezikshme, sipas RID-it dhe këtij ligji;

dh) i përcjell strukturës përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme të dhënat për certifikatat e këshilltarëve të sigurisë, aksidentet, incidentet, shkeljet dhe masat e marra në transportin hekurudhor të mallrave të rrezikshme.

Neni 12

Autoritetet doganore

1. Autoritetet doganore ushtrojnë funksionet e tyre gjatë importit, eksportit ose transitit të mallrave të rrezikshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin doganor, këtë ligj, ADR-në dhe RID-in.

2. Autoritetet doganore kryejnë këto detyra:

a) verifikojnë, gjatë kryerjes së formaliteteve doganore, dokumentet e transportit, dokumentet shoqëruese, autorizimet, certifikatat dhe të dhënat e tjera të kërkuara për mallrat e rrezikshme;

b) bashkëpunojnë me Policinë Rrugore, strukturën përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme dhe autoritetet e tjera kompetente për kontrollin e mallrave, mjeteve rrugore, vagonëve ose njësisë të transportit që përmbajnë mallra të rrezikshme në import, eksport ose transit;

c) njoftojnë autoritetet kompetente kur, gjatë kontrollit doganor, konstatohet ose dyshohet mungesë dokumentacioni, mospërputhje, deklaram i pasaktë, rrjedhje, dëmtim, rrezik për sigurinë ose rrezik për mjedisin;

ç) pezullojnë ose nuk vijojnë procedurën doganore, brenda kompetencës së tyre, kur mungojnë autorizimet ose dokumentet e kërkuara, ose kur konstatohet rrezik që kërkon ndërhyrjen e autoriteteve kompetente;

d) vendosin në dispozicion të autoriteteve kompetente të dhënat doganore të nevojshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 13

Autoritetet për materialet radioaktive, materialet bërthamore dhe lëndët plasëse

1. Autoritetet përgjegjëse për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese, sigurinë bërthamore dhe lëndët plasëse për përdorim civil ushtrojnë funksionet e tyre për autorizimin, kontrollin dhe përcaktimin e kushteve të posaçme të sigurisë për transportin e materialeve radioaktive, materialeve bërthamore dhe lëndëve plasëse, në përputhje me legjislacionin e posaçëm në fuqi, ADR-në, RID-in dhe këtë ligj.

2. Autoritetet sipas pikës 1 të këtij neni kryejnë këto detyra:

a) lëshojnë autorizimet, miratimet ose pëlqimet përkatëse për transportin e materialeve radioaktive, materialeve bërthamore ose lëndëve plasëse, kur këto kërkojnë sipas këtij ligji ose legjislacionit të posaçëm në fuqi;

b) përcaktojnë kushtet e posaçme të sigurisë për transportin, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë;

c) bashkëpunojnë me Policinë e Shtetit, autoritetet doganore, strukturën përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme dhe autoritetet e tjera kompetente;

ç) i përcjellin strukturës përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme të dhënat e nevojshme për autorizimet, aksidentet, incidentet, shkeljet dhe masat e marra në fushën e tyre të përgjegjësisë.

Neni 14

Autoritetet për pajisjet e transportueshme nën presion

1. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial ushtron funksionet e tij për pajisjet e transportueshme nën presion që përdoren në transportin rrugor ose hekurudhor të mallrave të rrezikshme, në përputhje me legjislacionin e posaçëm në fuqi, ADR-në, RID-in dhe këtë ligj.

2. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, sipas pikës 1 të këtij neni, kryen këto detyra:

a) kryen kontrollin, inspektimin dhe mbikëqyrjen e pajisjeve të transportueshme nën presion, sipas fushës së përgjegjësisë;

b) merr masat përkatëse kur konstaton se pajisja e transportueshme nën presion nuk përmbush kërkesat e sigurisë ose përdoret në kundërshtim me kërkesat e zbatueshme;

c) bashkëpunon me Policinë Rrugore, autoritetet doganore, strukturën përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme dhe autoritetet e tjera kompetente;

ç) i përcjell strukturës përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme të dhënat për inspektimet, mospërputhjet dhe masat e marra.

Neni 15

Bashkërendimi dhe shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet kompetente caktojnë pikat e kontaktit për zbatimin e këtij ligji dhe njoftojnë strukturën përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme për çdo ndryshim të tyre.

2. Autoritetet kompetente i vënë në dispozicion strukturës përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme informacionin e nevojshëm për monitorimin, raportimin dhe shkëmbimin e informacionit në fushën e transportit të mallrave të rrezikshme.

3. Struktura përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme organizon takime teknike me autoritetet kompetente, kur kjo është e nevojshme për zbatimin e këtij ligji, përgatitjen e raportimeve ose shkëmbimin e informacionit.

4. Shkëmbimi i informacionit sipas këtij neni kryhet në përputhje me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin tregtar, informacionin e klasifikuar dhe kufizimet që lidhen me hetimin administrativ, penal ose investigimin teknik.

KREU III

PJESËMARRËSIT NË TRANSPORT DHE DETYRIMET E TYRE

SEKSIONI 1

DETYRIMET E PJESËMARRËSVE NË TRANSPORT

Neni 16

Detyrimet e përgjithshme të pjesëmarrësve në transport

1. Pjesëmarrësit në transportin e mallrave të rrezikshme marrin të gjitha masat e nevojshme, në përputhje me natyrën dhe shkallën e rreziqeve të parashikueshme, për të shmangur dëmet ndaj jetës dhe shëndetit të njerëzve, pronës dhe mjedisit ose, kur kjo nuk është e mundur, për të kufizuar pasojat e tyre.

2. Pjesëmarrësit në transport përmbushin detyrimet e përgjithshme të sigurisë të përcaktuara në seksionin 1.4.1 të ADR-së ose RID-it, si dhe detyrimet që u takojnë sipas rolit përkatës në transport.

Neni 17

Dërguesi

1. Dërguesi përmbush detyrimet e përcaktuara në nënseksionin 1.4.2.1 të ADR-së ose RID-it.

2. Dërguesi dorëzon për transport vetëm mallra të rrezikshme që janë klasifikuar, identifikuar dhe lejuar për transport në përputhje me ADR-në ose RID-in dhe siguron që transportuesit t'i jepen dokumentet, autorizimet, miratimet ose njoftimet e kërkuara sipas ADR-së, RID-it, këtij ligji ose legjislacionit të posaçëm në fuqi.

3. Dërguesi siguron që ambalazhet, cisternat, kontejnerët ose pajisjet e transportueshme nën presion që përdoren për dërgesën dhe që janë nën përgjegjësinë e tij sipas ADR-së ose RID-it, të jenë të përshtatshme për mallrat përkatëse dhe të jenë të shënuara, etiketuara ose pajisura me shenjat e kërkuara, në përputhje me ADR-në ose RID-in.

4. Për materialet radioaktive, dërguesi siguron përmbushjen e kërkesave të posaçme sipas ADR-së, RID-it dhe legjislacionit të posaçëm në fuqi për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe sigurinë bërthamore.

5. Dërguesi siguron që ambalazhet bosh të papastruara, cisternat bosh të papastruara, kontejnerët, mjetet ose vagonët që kanë përmbajtur mallra të rrezikshme të dorëzohen për transport vetëm kur janë mbyllur, shënuar dhe trajtuar në përputhje me ADR-në ose RID-in.

6. Kur dërguesi përdor shërbimet e pjesëmarrësve të tjerë në transport, ai merr masat e nevojshme që dërgesa të përmbushë kërkesat e këtij ligji, ADR-së ose RID-it, duke u mbështetur, për aq sa është e arsyeshme, në informacionin dhe dokumentet që i jepen nga këta pjesëmarrës.

7. Kur dërguesi vepron në emër të një pale të tretë, pala e tretë i jep dërguesit me shkrim të gjithë informacionin dhe dokumentet e nevojshme për klasifikimin, identifikimin dhe transportin e mallrave të rrezikshme.

Neni 18

Transportuesi

1. Transportuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në nënseksionin 1.4.2.2 të ADR-së ose RID-it.

2. Transportuesi pranon dhe kryen transportin e mallrave të rrezikshme vetëm pasi të verifikojë, për aq sa kërkohet prej tij sipas ADR-së ose RID-it dhe për aq sa është e dukshme ose dokumentare, se janë plotësuar kërkesat që i takojnë sipas rolit të tij në ADR ose RID, përfshirë verifikimin e dokumenteve, autorizimeve, gjendjes së dukshme të mjetit, vagonit, cisternës, kontejnerit ose ngarkesës, shenjave të kërkuara dhe pajisjeve të nevojshme për transportin rrugor, kur këto kërkohen.

3. Për verifikimet që varen nga informacioni, dokumentet, autorizimet, miratimet ose njoftimet e dhëna nga dërguesi ose pjesëmarrësit e tjerë në transport, transportuesi mund të mbështetet në këto të dhëna, përveç rasteve kur mospërputhja është e dukshme.

4. Nëse transportuesi konstaton, përpara fillimit të transportit, se nuk janë përmbushur kërkesat e këtij ligji, ADR-së ose RID-it dhe mospërputhja mund të cenojë sigurinë, ai nuk e fillon transportin deri në korrigjimin e saj.

5. Nëse mospërputhja konstatohet gjatë transportit dhe mund të cenojë sigurinë, transportuesi ndalon transportin sa më shpejt që kjo mund të bëhet pa rrezik dhe merr masat e nevojshme për vijimin e sigurt të transportit ose për njoftimin e autoriteteve kompetente.

Neni 19

Marrësi

1. Marrësi përmbush detyrimet e përcaktuara në nënseksionin 1.4.2.3 të ADR-së ose RID-it.

2. Marrësi nuk refuzon ose vonon pranimin e mallrave të rrezikshme pa shkak të justifikuar.

3. Pas shkarkimit, marrësi verifikon që shkarkimi, pastrimi, dekontaminimi dhe heqja e shenjave të rrezikut të jenë kryer në përputhje me ADR-në ose RID-in, kur këto veprime kryhen prej tij ose nga persona të angazhuar prej tij.

4. Kur pas shkarkimit konstatohet mospërputhje që mund të cenojë sigurinë, marrësi merr masat e nevojshme që mjete, vagoni, cisterna ose kontejneri të mos kthehet për përdorim ose transport të mëtejshëm derisa mospërputhja të jetë korrigjuar.

5. Kur marrësi përdor shërbimet e pjesëmarrësve të tjerë, përfshirë shkarkuesin, pastruesin ose dekontaminuesin, ai merr masat e nevojshme për të siguruar përmbushjen e kërkesave për pranimin, shkarkimin, pastrimin ose dekontaminimin e mallrave të rrezikshme.

Neni 20

Ngarkuesi

1. Ngarkuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në nënseksionin 1.4.3.1 të ADR-së ose RID-it.

2. Ngarkuesi dorëzon te transportuesi vetëm mallra të rrezikshme që lejohen për transport dhe që përmbushin kërkesat e këtij ligji, ADR-së ose RID-it.

3. Gjatë dorëzimit për transport të mallrave të rrezikshme të ambalazuara ose të ambalazheve bosh të papastruara, ngarkuesi kontrollon gjendjen e dukshme të ambalazhit dhe nuk dorëzon për transport paketë ose ambalazh që është dukshëm i dëmtuar, me rrjedhje ose me rrezik rrjedhjeje, derisa mospërputhja të jetë korrigjuar.

4. Kur ngarkon mallra të rrezikshme në mjet, vagon ose kontejner, ngarkuesi zbaton kërkesat për ngarkimin, vendosjen, trajtimin dhe sigurimin e ngarkesës, sipas ADR-së ose RID-it.

5. Ngarkuesi zbaton ndalimet për ngarkimin e përzier dhe kërkesat për ndarjen e mallrave të rrezikshme nga ushqimet, artikujt e konsumit ose ushqimet për kafshë, sipas ADR-së ose RID-it.

6. Ngarkuesi siguron që, për aq sa lidhet me veprimet e ngarkimit, mjete, vagoni ose kontejneri të mbajë shënimet, etiketat, pllakat-etiketa, panelet portokalli ose shenjat e tjera të kërkuara sipas ADR-së ose RID-it.

Neni 21

Shkarkuesi

1. Shkarkuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në nënseksionin 1.4.3.7 të ADR-së ose RID-it.

2. Para shkarkimit, shkarkuesi verifikon që mallrat që do të shkarkohen përputhen me informacionin në dokumentin e transportit dhe me të dhënat e vendosura mbi paketën, kontejnerin, cisternën, mjetin ose vagonin.

3. Para dhe gjatë shkarkimit, shkarkuesi kontrollon nëse ambalazhi, cisterna, mjeti, vagoni ose kontejneri paraqet dëmtime që mund të rrezikojnë operacionin e shkarkimit.

4. Kur konstatohet dëmtim, rrjedhje ose mospërputhje që mund të cenojë sigurinë, shkarkuesi nuk kryen shkarkimin derisa të jenë marrë masat e nevojshme për kryerjen e sigurt të tij.

5. Pas shkarkimit, shkarkuesi siguron që pajisjet e shkarkimit, valvulat, kapakët ose hapjet përkatëse të jenë të mbyllura dhe të mos paraqesin rrjedhje.

6. Shkarkuesi zbaton kërkesat për shkarkimin, pastrimin, dekontaminimin dhe trajtimin e mbetjeve ose materialeve të kontaminuara, për aq sa këto veprime kryhen prej tij ose nga persona të angazhuar prej tij.

7. Pas shkarkimit, pastrimit dhe dekontaminimit, shkarkuesi siguron që mjeti, vagoni, cisterna ose kontejneri të mos mbajë më shenja rreziku, përveç rasteve kur ADR-ja ose RID-i parashikon ndryshe.

Neni 22

Ambalazhuesi

1. Ambalazhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në nënseksionin 1.4.3.2 të ADR-së ose RID-it.

2. Ambalazhuesi përdor vetëm ambalazhe, ambalazhe të mëdha ose kontejnerë të ndërmjetëm që lejohen për mallrat përkatëse sipas ADR-së ose RID-it.

3. Ambalazhuesi zbaton kërkesat për ambalazhimin dhe ambalazhimin e përzier të mallrave të rrezikshme, sipas ADR-së ose RID-it.

4. Ambalazhuesi siguron që paketat të përgatiten në përputhje me kërkesat teknike për ambalazhet, sipas ADR-së ose RID-it, kur këto kërkesa zbatohen për ambalazhin përkatës.

5. Ambalazhuesi vendos mbi paketa shënimet, mbishkrimet, kodet dhe etiketat e rrezikut të kërkuara sipas ADR-së ose RID-it.

Neni 23

Mbushësi

1. Mbushësi përmbush detyrimet e përcaktuara në nënseksionin 1.4.3.3 të ADR-së ose RID-it.

2. Para fillimit të mbushjes, mbushësi verifikon që cisterna, mjeti, vagoni, kontejneri ose pajisja tjetër që do të mbushet është në gjendje të përshtatshme teknike dhe se afati i testimit, kontrollit ose inspektimit periodik nuk ka përfunduar, kur një testim, kontroll ose inspektim i tillë kërkohet sipas ADR-së ose RID-it.

3. Mbushësi mbush cisternat, mjetet, vagonët, kontejnerët ose pajisjet e tjera vetëm me mallra të rrezikshme që lejohen për transport në to, sipas ADR-së ose RID-it.

4. Gjatë mbushjes, mbushësi zbaton kërkesat për ndarjet ose dhomat ngjitur të cisternës, si dhe kërkesat për papajtueshmërinë e mallrave të rrezikshme, sipas ADR-së ose RID-it.

5. Mbushësi respekton nivelin maksimal të mbushjes, masën maksimale të përmbajtjes ose kufijtë e tjerë të lejuar për mallin e rrezikshëm që mbushet.

6. Pas mbushjes, mbushësi kontrollon që pajisjet e mbylljes dhe të shkarkimit të jenë të mbyllura dhe të mos paraqesin rrjedhje.

7. Mbushësi siguron që në sipërfaqen e jashtme të cisternës, mjetit, vagonit, kontejnerit ose pajisjes tjetër të mbushur prej tij të mos ketë mbetje të mallrave të rrezikshme.

8. Mbushësi siguron që cisterna, mjeti, vagoni ose kontejneri të mbajë panelet portokalli, pllakat-etiketa, etiketat dhe shenjat e tjera të kërkuara sipas ADR-së ose RID-it.

9. Kur mbush mjete, vagonë ose kontejnerë me mallra të rrezikshme në masë, mbushësi zbaton kërkesat përkatëse të ADR-së ose RID-it.

Neni 24

Operatori i kontejnerit-cisternë, cisternës së lëvizshme dhe vagonit-cisternë

1. Operatori i kontejnerit-cisternë, cisternës së lëvizshme dhe vagonit-cisternë përmbush detyrimet e përcaktuara në nënseksionin 1.4.3.4 të ADR-së ose në nënseksionet përkatëse të RID-it për operatorin e cisternës.

2. Operatori siguron që kontejneri-cisternë, cisterna e lëvizshme ose vagoni-cisternë të përmbushë kërkesat për ndërtimin, pajisjen, testimin, inspektimin dhe shënimin, sipas ADR-së ose RID-it.

3. Operatori siguron mirëmbajtjen e cisternës dhe të pajisjeve të saj, në mënyrë që përputhja me kërkesat e ADR-së ose RID-it të ruhet deri në testimin ose inspektimin e radhës.

4. Operatori siguron kryerjen e inspektimit të jashtëzakonshëm kur siguria e cisternës ose e pajisjeve të saj mund të jetë cenuar nga riparimi, ndryshimi, dëmtimi, aksidenti ose çdo ngjarje tjetër që mund të ndikojë në sigurinë e saj.

5. Operatori mban dhe, kur kërkohet, vë në dispozicion të autoriteteve kompetente dokumentacionin teknik, certifikatat, raportet e testimit ose të inspektimit dhe dokumentet e tjera që provojnë përputhjen e cisternës me kërkesat e ADR-së ose RID-it.

6. Operatori nuk lejon përdorimin e kontejnerit-cisternë, cisternës së lëvizshme ose vagonit-cisternë kur afati i testimit ose inspektimit të kërkuar ka përfunduar, ose kur gjendja teknike e cisternës mund të cenojë sigurinë e transportit.

Neni 25

Drejtuesi i mjetit rrugor

1. Drejtuesi i mjetit rrugor që transporton mallra të rrezikshme përmbush detyrimet që i ngarkohen sipas ADR-së dhe këtij ligji.

2. Drejtuesi i mjetit rrugor kryen transportin e mallrave të rrezikshme vetëm kur është i pajisur me certifikatën e trajnimit të drejtuesit të mjetit sipas ADR-së, kur ajo kërkohet sipas ADR-së.

3. Drejtuesi i mjetit rrugor mban në njësinë e transportit dokumentin e transportit, udhëzimet me shkrim, certifikatën e trajnimit të drejtuesit të mjetit sipas ADR-së, certifikatën e miratimit ADR për mjetin rrugor dhe dokumentet e tjera që kërkohen sipas ADR-së dhe këtij ligji.

4. Drejtuesi i mjetit rrugor zbaton udhëzimet me shkrim dhe masat e sigurisë në rast aksidenti, incidenti, derdhjeje, rrjedhjeje ose rreziku tjetër gjatë transportit.

5. Drejtuesi i mjetit rrugor njofton menjëherë transportuesin dhe nuk vijon transportin kur konstaton paketa ose ambalazhe dukshëm të dëmtuara, me rrjedhje ose me rrezik rrjedhjeje, nëse vijimi i transportit mund të cenojë sigurinë.

6. Drejtuesi i mjetit rrugor respekton kërkesat për pajisjet e njësisë së transportit, pajisjet e mbrojtjes personale, ndalimet, kufizimet e itinerarit ose të kalimit dhe rregullat e tjera të zbatueshme për transportin rrugor të mallrave të rrezikshme sipas ADR-së.

SEKSIONI 2

KËSHILLTARI I SIGURISË, TRAJNIMI DHE CERTIFIKIMI

Neni 26

Caktimi i këshilltarit të sigurisë

1. Subjekti me seli ose i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, veprimtaria e të cilit përfshin dërgimin, transportin, ambalazhimin, ngarkimin, mbushjen ose shkarkimin e mallrave të rrezikshme, cakton një ose më shumë këshilltarë sigurie për transportin e mallrave të rrezikshme, në përputhje me seksionin 1.8.3 të ADR-së ose RID-it.

2. Detyrimi për caktimin e këshilltarit të sigurisë nuk zbatohet në rastet e përjashtuara sipas nënseksionit 1.8.3.2 të ADR-së ose RID-it.

3. Funksinin e këshilltarit të sigurisë mund ta kryejë një person i punësuar nga subjekti, drejtuesi i subjektit ose një person i jashtëm, me kusht që të jetë i pajisur me certifikatë të vlefshme të formimit profesional për këshilltar sigurie.

4. Subjekti njofton strukturën përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme për caktimin e këshilltarit të sigurisë, jo më vonë se 15 ditë nga data e caktimit.

5. Njoftimi sipas pikës 4 të këtij neni përmban identitetin e këshilltarit të sigurisë, të dhënat e certifikatës, autoritetin që e ka lëshuar, fushën e vlefshmërisë së saj dhe të dhënat e kontaktit.

6. Çdo ndryshim lidhur me këshilltarin e sigurisë ose me të dhënat e njoftuara sipas pikës 5 të këtij neni njoftohet brenda 15 ditëve nga data e ndryshimit.

Neni 27

Funksionet e këshilltarit të sigurisë

1. Këshilltari i sigurisë kryen funksionet e përcaktuara në nënseksionin 1.8.3.3 të ADR-së ose RID-it, në përputhje me veprimtarinë e subjektit për të cilin është caktuar.

2. Raporti vjetor i këshilltarit të sigurisë i paraqitet drejtuesit të subjektit, ruhet nga subjekti për pesë vjet dhe vihet në dispozicion të autoriteteve kompetente, kur kërkohet.

3. Në rast aksidenti ose incidenti gjatë dërgimit, transportit, ambalazhimit, ngarkimit, mbushjes ose shkarkimit të mallrave të rrezikshme, këshilltari i sigurisë përgatit raportin përkatës për drejtimin e subjektit, kur ky raport kërkohet në përputhje me seksionin 1.8.3 të ADR-së ose RID-it.

Neni 28

Certifikimi i këshilltarit të sigurisë

1. Këshilltari i sigurisë pajiset me certifikatë të formimit profesional, të lëshuar pas kalimit të provimit përkatës, në përputhje me seksionin 1.8.3 të ADR-së ose RID-it.

2. Certifikata e këshilltarit të sigurisë lëshohet për mënyrën përkatëse të transportit dhe për klasat ose grupet e mallrave të rrezikshme për të cilat është kryer provimi.

3. Certifikata e këshilltarit të sigurisë për transportin rrugor të mallrave të rrezikshme, sipas ADR-së, lëshohet, rinovohet, pezullohet ose revokohet nga DPSHTRR-ja.

4. Certifikata e këshilltarit të sigurisë për transportin hekurudhor të mallrave të rrezikshme, sipas RID-it, lëshohet, rinovohet, pezullohet ose revokohet nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore.

5. Certifikatat e këshilltarëve të sigurisë të lëshuara nga autoritetet kompetente të shteteve të tjera palë në ADR ose RID njihen në Republikën e Shqipërisë.

6. Struktura përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme administron të dhënat për këshilltarët e sigurisë të njoftuar nga subjektet dhe për certifikatat përkatëse, mbi bazën e të dhënave të përcjella nga DPSHTRR-ja dhe Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore.

Neni 29

Trajnimi i personave të përfshirë në transportin e mallrave të rrezikshme

1. Pjesëmarrësit në transport sigurojnë që personat që veprojnë nën përgjegjësinë e tyre dhe që marrin pjesë në dërgimin, transportin, ambalazhimin, ngarkimin, mbushjen, shkarkimin ose veprimtari të tjera të lidhura me mallrat e rrezikshme të trajnohen në përputhje me kreun 1.3 të ADR-së ose RID-it.

2. Kur personat përfshihen në veprimtari për të cilat zbatohen kërkesat e sigurisë sipas kreut 1.10 të ADR-së ose RID-it, trajnimi përfshin edhe këto kërkesa.

3. Punëdhënësi mban të dhënat për trajnimin e kryer për të paktën 5 vjet dhe i vë ato në dispozicion të autoriteteve kompetente, kur kërkohen.

Neni 30

Trajnimi dhe certifikimi i drejtuesve të mjeteve rrugore

1. Drejtuesi i mjetit rrugor që transporton mallra të rrezikshme pajiset me certifikatën përkatëse të trajnimit, kur kjo kërkohet sipas kreut 8.2 të ADR-së.

2. Trajnimi dhe provimi i drejtuesve të mjeteve rrugore kryhen në përputhje me kërkesat e kreut 8.2 të ADR-së.

3. Certifikata e trajnimit të drejtuesit të mjetit sipas ADR-së lëshohet, rinovohet, pezullohet ose revokohet nga DPSHTRR-ja, në përputhje me këtë ligj dhe ADR-në.

4. Certifikatat e trajnimit të drejtuesve të mjeteve rrugore të lëshuara nga autoritetet kompetente të shteteve të tjera palë në ADR njihen në Republikën e Shqipërisë.

5. DPSHTRR-ja administron të dhënat për certifikatat e trajnimit të drejtuesve të mjeteve rrugore.

6. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për transportin, përcakton me vendim rregullat e hollësishme për formimin profesional, trajnimin, provimin dhe certifikimin e këshilltarëve të sigurisë dhe drejtuesve të mjeteve rrugore, të cilat përfshijnë:

a) programet e formimit profesional të këshilltarëve të sigurisë dhe programet e trajnimit të drejtuesve të mjeteve rrugore;

b) organizimin e provimeve për këshilltarët e sigurisë dhe drejtuesit e mjeteve rrugore;

c) lëshimin, rinovimin, pezullimin, revokimin, zëvendësimin, formën dhe administrimin e certifikatave përkatëse nga autoritetet kompetente sipas këtij ligji;

ç) autorizimin, mbikëqyrjen, pezullimin dhe revokimin e autorizimit të subjekteve që kryejnë formimin profesional ose trajnimin sipas këtij seksioni;

d) tarifat për provimin, lëshimin, rinovimin, zëvendësimin dhe administrimin e certifikatave, si dhe tarifat për procedurat e autorizimit të subjekteve të formimit profesional ose trajnimit, sipas autoritetit kompetent përkatës.

KREU IV

AMBALAZHET, CISTERNAT, PAJISJET E TRANSPORTUESHME NËN PRESION, MJETET DHE VAGONËT

SEKSIONI 1

AMBALAZHET

Neni 31

Ambalazhet e lejuara

1. Për transportin e mallrave të rrezikshme përdoren vetëm ambalazhe, ambalazhe të mëdha dhe kontejnerë të ndërmjetëm që lejohen për mallrat përkatëse dhe që përmbushin kërkesat e ADR-së ose RID-it.

2. Paketat që përmbajnë mallra të rrezikshme shënohen dhe etiketohen në përputhje me ADR-në ose RID-in.

3. Nuk lejohet përdorimi për transport i ambalazheve të dëmtuara, me rrjedhje, me rrezik rrjedhjeje ose që nuk përputhen me tipin e miratuar, kur miratimi kërkohet sipas ADR-së ose RID-it.

Neni 32

Miratimi, testimi dhe shënimi i ambalazheve

1. Kur ADR-ja ose RID-i kërkon miratimin e tipit, testimin ose kontrollin e ambalazhit, prodhuesi ose subjekti përgjegjës siguron kryerjen e tyre nga organi i miratuar ose nga autoriteti përgjegjës sipas fushës përkatëse të përgjegjësisë.

2. Prodhuesi ose subjekti përgjegjës vendos në ambalazh shenjat, kodet, mbishkrimet ose të dhënat e miratimit vetëm kur ambalazhi është në përputhje me tipin e miratuar dhe me kërkesat e ADR-së ose RID-it.

3. Nuk lejohet vendosja ose përdorimi i shenjave, kodeve, mbishkrimeve, etiketave ose të dhënave që mund të shkaktojnë ngatërrim me shenjat e miratimit, shenjat e rrezikut ose shenjat e tjera të kërkuara sipas ADR-së ose RID-it.

4. Ambalazhet e miratuara, të testuara dhe të shënuara në përputhje me ADR-në ose RID-in nga autoriteti kompetent ose organi i miratuar i një shteti tjetër palë në ADR ose RID njihen për qëllime të transportit të mallrave të rrezikshme, përveç rasteve kur konstatohet mospërputhje me kërkesat e këtij ligji, ADR-së ose RID-it.

Neni 33

Ambalazhet për materiale radioaktive dhe materiale bërthamore

1. Ambalazhet që përdoren për transportin e materialeve radioaktive ose materialeve bërthamore duhet të përmbushin kërkesat e posaçme të ADR-së ose RID-it, si dhe kërkesat e legjislacionit të posaçëm për mbrojtjen nga rrezatimet dhe për sigurinë bërthamore.

2. Kur sipas ADR-së, RID-it ose legjislacionit të posaçëm kërkohet miratim për ambalazhin e materialeve radioaktive, miratimi jepet nga autoriteti kompetent për mbrojtjen nga rrezatimet, sipas kompetencave të përcaktuara në legjislacionin e posaçëm në fuqi.

3. Kur sipas ADR-së, RID-it ose legjislacionit të posaçëm kërkohet miratim për ambalazhin e materialeve bërthamore, miratimi jepet nga autoriteti përgjegjës për sigurinë bërthamore, sipas kompetencave të përcaktuara në legjislacionin e posaçëm në fuqi.

4. Për dhënien e miratimit mund të merren në konsideratë rezultatet e testimit, certifikatat ose miratimet e lëshuara nga autoriteti kompetent ose organi i miratuar i një shteti tjetër palë në ADR ose RID, kur ato janë lëshuar në përputhje me ADR-në ose RID-in.

Neni 34

Pezullimi dhe revokimi i miratimit të ambalazhit

1. Kur organi i mbikëqyrjes së tregut, organi i inspektimit ose organi tjetër përgjegjës konstaton se ambalazhi nuk është në përputhje me këtë ligj, ADR-në ose RID-in, ai merr masat që i takojnë sipas kompetencës së tij për të ndaluar përdorimin e ambalazhit për transportin e mallrave të rrezikshme, kur përdorimi i tij mund të cenojë sigurinë, dhe njofton menjëherë autoritetin kompetent ose organin që ka dhënë miratimin.

2. Organi ose autoriteti që ka dhënë miratimin, pas marrjes së njoftimit sipas pikës 1 të këtij neni, fillon procedurën për pezullimin ose revokimin e miratimit të ambalazhit, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

3. Ambalazhi për të cilin është pezulluar ose revokuar miratimi nuk përdoret për transportin e mallrave të rrezikshme deri në rivendosjen e përputhshmërisë dhe, kur kërkohet, deri në dhënien e një miratimi të ri.

4. Kur mospërputhja lidhet me ambalazh të miratuar nga autoriteti kompetent ose organi i miratuar i një shteti tjetër palë në ADR ose RID, struktura përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme njofton, sipas rastit, autoritetin përkatës të shtetit që ka dhënë miratimin.

SEKSIONI 2

CISTERNAT, PAJISJET E TRANSPORTUESHME NËN PRESION DHE ORGANET E MIRATUARA

Neni 35

Cisternat, kontejnerët-cisternë, cisternat e lëvizshme dhe vagonët-cisternë

1. Mallrat e rrezikshme transportohen në cisterna, kontejnerë-cisternë, cisterna të lëvizshme ose vagonë-cisternë vetëm kur këto lejohen për mallrat përkatëse sipas ADR-së ose RID-it.

2. Cisternat, kontejnerët-cisternë, cisternat e lëvizshme dhe vagonët-cisternë duhet të jenë të ndërtuar, pajisur, testuar, inspektuar, miratuar dhe shënuar në përputhje me ADR-në ose RID-in.

3. Cisternat, kontejnerët-cisternë, cisternat e lëvizshme dhe vagonët-cisternë përdoren vetëm brenda afatit të vlefshmërisë së testimit ose inspektimit të kërkuar sipas ADR-së ose RID-it.

4. Nuk lejohet përdorimi për transport i cisternave, kontejnerëve-cisternë, cisternave të lëvizshme ose vagonëve-cisternë që janë të dëmtuar, që paraqesin rrjedhje, që nuk përputhen me tipin e miratuar ose që nuk përmbushin kërkesat e ADR-së ose RID-it.

5. Cisternat, kontejnerët-cisternë, cisternat e lëvizshme dhe vagonët-cisternë të miratuar, testuar, inspektuar dhe shënuar nga autoriteti kompetent ose organi i miratuar i një shteti tjetër palë në ADR ose RID njihen për qëllime transporti në Republikën e Shqipërisë.

6. Kur cisternat, kontejnerët-cisternë, cisternat e lëvizshme ose pajisjet e tyre përbëjnë ose përfshijnë pajisje të transportueshme nën presion, funksionet e kontrollit, inspektimit, mbikëqyrjes dhe marrjes së masave përkatëse ushtrohen nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi për pajisjet e transportueshme nën presion, ADR-së, RID-it dhe këtij ligji.

Neni 36

Organet e miratuara për testimin, kontrollin dhe vlerësimin e përputhshmërisë

1. Kur ADR-ja, RID-i ose legjislacioni i posaçëm në fuqi kërkon që testimi, kontrolli, inspektimi ose vlerësimi i përputhshmërisë së ambalazheve, cisternave, pajisjeve të transportueshme nën presion, mjeteve ose vagonëve të kryhet nga autoritet kompetent ose organ i miratuar, ky funksion ushtrohet nga autoriteti kompetent ose organi i miratuar sipas fushës përkatëse të përgjegjësisë.

2. Organi i miratuar kryen vetëm procedurat për të cilat është miratuar ose autorizuar dhe vetëm në përputhje me ADR-në, RID-in, këtë ligj dhe legjislacionin e posaçëm në fuqi.

3. Miratimi, autorizimi, mbikëqyrja, pezullimi dhe revokimi i organeve sipas këtij neni kryhen sipas legjislacionit të posaçëm që rregullon fushën përkatëse, përfshirë legjislacionin për pajisjet e transportueshme nën presion, kur është rasti.

4. Për pajisjet e transportueshme nën presion që përdoren në transportin rrugor ose hekurudhor të mallrave të rrezikshme, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial ushtron funksionet e autoritetit kompetent për kontrollin, inspektimin, mbikëqyrjen dhe ndjekjen e përputhshmërisë, sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi, ADR-së, RID-it dhe këtij ligji.

SEKSIONI 3

MJETET RRUGORE DHE VAGONËT

Neni 37

Mjetet rrugore për transportin e mallrave të rrezikshme

1. Mallrat e rrezikshme transportohen me mjete rrugore ose njësi transporti vetëm kur këto përmbushin kërkesat e ADR-së, këtij ligji dhe legjislacionit për qarkullimin rrugor.

2. Mjeti rrugor ose njësia e transportit duhet të jetë e pajisur me dokumentet, pajisjet, shenjat, panelet portokalli, pllakat-etiketa dhe mjetet e sigurisë që kërkojnë sipas ADR-së, për llojin e mallrave të rrezikshme dhe mënyrën e transportit.

3. Nuk lejohet përdorimi për transport i mjetit rrugor ose njësisë së transportit që paraqet dëmtime të dukshme, rrjedhje, mospërputhje teknike ose mungesë të pajisjeve të kërkuara, kur këto mund të cenojnë sigurinë e transportit.

Neni 38

Autorizimi i personave juridikë për inspektimin teknik të mjeteve ADR

1. Inspektimi teknik i përputhshmërisë së mjeteve rrugore, për të cilat kërkohet certifikata e miratimit sipas ADR-së, kryhet nga persona juridikë të autorizuar nga ministri përgjegjës për transportin.

2. Autorizimi jepet kur personi juridik është i akredituar për fushën përkatëse të inspektimit të mjeteve ADR dhe përmbush kushtet e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas pikës 7 të këtij neni.

3. Personi juridik i autorizuar kryen inspektimin teknik të përputhshmërisë së mjetit rrugor, harton raportin teknik, në të cilin pasqyron rezultatet e inspektimit, dhe ia përcjell atë DPSHTRR-së, së bashku me dokumentacionin përkatës.

4. Ministri përgjegjës për transportin pezullon autorizimin kur:

a) akreditimi i personit juridik pezullohet ose fusha e tij kufizohet në mënyrë të tillë që nuk mbulon përkohësisht veprimtarinë për të cilën është dhënë autorizimi;

b) personi juridik nuk përmbush një nga kushtet e autorizimit dhe mospërputhja mund të korrigjohet;

c) nga gjetjet e organit përgjegjës për akreditimin ose nga të dhënat dhe dokumentacioni i administruar nga DPSHTRR-ja rezulton se inspektimi ose raporti teknik është kryer apo hartuar në kundërshtim me kërkesat e ADR-së ose kushtet e autorizimit.

Pezullimi zgjat deri në korrigjimin e shkakut që e ka sjellë, por jo më shumë se tre muaj.

5. Ministri përgjegjës për transportin revokon autorizimin kur:

a) akreditimi revokohet ose fusha e tij nuk mbulon më veprimtarinë për të cilën është dhënë autorizimi;

b) autorizimi është marrë mbi bazën e dokumenteve ose të dhënave të rreme;

c) shkakut i pezullimit nuk është korrigjuar brenda afatit të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni;

ç) personi juridik kryen inspektime gjatë periudhës së pezullimit;

d) personi juridik përsërit, brenda një viti nga përfundimi i pezullimit, shkeljen që ka sjellë pezullimin e autorizimit.

6. Vendimi për pezullimin ose revokimin e autorizimit i njoftohet menjëherë DPSHTRR-së, e cila bllokoi aksesin e personit juridik në regjistrin elektronik. Raporti teknik i hartuar gjatë periudhës së pezullimit ose pas revokimit të autorizimit nuk mund të shërbejë si bazë për lëshimin ose rinovimin e certifikatës së miratimit ADR.

7. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për transportin, përcakton me vendim:

a) procedurën, dokumentacionin, afatet dhe tarifën administrative për shqyrtimin e kërkesës dhe dhënien e autorizimit;

b) standardin dhe fushën e akreditimit, si dhe kushtet teknike, profesionale dhe organizative që duhet të përmbushë personi juridik;

c) procedurat për inspektimin dhe riinspektimin e mjeteve, përmbajtjen e raportit teknik dhe mënyrën e përcjelljes së tij në DPSHTRR;

ç) procedurat për korrigjimin e mospërputhjeve, pezullimin dhe revokimin e autorizimit;

d) shkëmbimin e informacionit me organin përgjegjës për akreditimin dhe DPSHTRR-në, si dhe dorëzimin dhe ruajtjen e dokumentacionit pas ndërprerjes së veprimtarisë;

dh) kufijtë maksimalë të tarifave të shërbimit për inspektimin dhe riinspektimin e mjeteve.

Neni 39

Certifikata e miratimit ADR për mjetin rrugor

1. Certifikata e miratimit ADR për mjetin rrugor lëshohet, rinovohet, pezullohet ose revokohet nga DPSHTRR-ja, për mjetet për të cilat kjo certifikatë kërkohet sipas ADR-së.

2. Certifikata e miratimit ADR lëshohet vetëm kur raporti teknik i inspektimit, i hartuar nga personi juridik i autorizuar sipas nenit 38 të këtij ligji, vërteton se mjeti rrugor përmbush kërkesat teknike përkatëse të ADR-së dhe DPSHTRR-ja ka verifikuar plotësinë e dokumentacionit, përputhjen e të dhënave identifikuese të mjetit dhe përmbushjen e kërkesave të legjislacionit për qarkullimin rrugor.

3. Të dhënat për certifikatat e miratimit ADR të mjeteve rrugore administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

4. Certifikatat e miratimit ADR të lëshuara në shtete të tjera palë në ADR njihen për qëllime transporti në Republikën e Shqipërisë, kur janë të vlefshme dhe janë lëshuar në përputhje me ADR-në.

5. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për transportin, përcakton:

a) procedurën për paraqitjen e kërkesës për lëshimin ose rinovimin e certifikatës së miratimit ADR;

b) dokumentacionin që paraqitet nga kërkuesi dhe mënyrën e verifikimit të tij;

c) procedurën për paraqitjen dhe verifikimin nga DPSHTRR-ja të raportit teknik të inspektimit, dokumentacionit shoqërues, të dhënave identifikuese të mjetit dhe përmbushjes së kërkesave të legjislacionit për qarkullimin rrugor;

ç) lëshimin, rinovimin, vlefshmërinë, formën, përmbajtjen dhe administrimin e certifikatës së miratimit ADR;

d) rastet dhe procedurën për pezullimin ose revokimin e certifikatës së miratimit ADR;

dh) procedurën për zëvendësimin e certifikatës në rast humbjeje, dëmtimi, ndryshimi të të dhënave ose pavlefshmërie të dokumentit;

e) mbajtjen e regjistrit të certifikatave të miratimit ADR dhe shkëmbimin e të dhënave me autoritetet kompetente;

ë) tarifat për lëshimin, rinovimin, zëvendësimin dhe administrimin e certifikatës së miratimit ADR.

Neni 40

Vagonët për transportin e mallrave të rrezikshme

1. Mallrat e rrezikshme transportohen me vagonë vetëm kur këta lejohen për mallrat përkatëse dhe përmbushin kërkesat e RID-it, këtij ligji dhe legjislacionit për sigurinë hekurudhore.

2. Nuk lejohet përdorimi për transport i vagonit që paraqet dëmtime të dukshme, rrjedhje, mospërputhje teknike, mungesë të shenjave të kërkuara ose gjendje tjetër që mund të cenojë sigurinë e transportit.

KREU V

AUTORIZIMET DHE KUSHTET E POSAÇME PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE TË CAKTUARA TË RREZIKSHME

Neni 41

Mallrat që transportohen me autorizim

1. Transporti i lëndëve plasëse, materialeve radioaktive dhe materialeve bërthamore kryhet vetëm me autorizim, përveç rasteve kur transporti kryhet në përputhje me përjashtimet e parashikuara në ADR ose RID.

2. Autorizimi për transportin e:

a) lëndëve plasëse lëshohet nga autoriteti përgjegjës për lëndët plasëse për përdorim civil ose nga autoriteti tjetër i përcaktuar sipas legjislacionit përkatës në fuqi;

b) materialeve radioaktive lëshohet nga autoriteti përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese, sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi;

c) materialeve bërthamore lëshohet nga autoriteti përgjegjës për sigurinë bërthamore.

3. Autorizimi lëshohet dhe zbatohet në përputhje me këtë ligj, ADR-në ose RID-in, kushtet e përcaktuara në autorizim dhe kërkesat e sigurisë që zbatohen për llojin përkatës të mallrave.

4. Kur sipas legjislacionit të posaçëm kërkohen licenca, leje, miratime, pëlqime ose njoftime për prodhimin, përdorimin, ruajtjen, importimin, eksportimin, transitin, mbrojtjen fizike ose kontrollin e mallrave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, subjekti i autorizuar duhet t'i disponojë ose t'i kryejë ato në kohën dhe mënyrën e kërkuar nga legjislacioni përkatës.

Neni 42

Kërkesa për autorizim

1. Kërkesa për autorizim paraqitet me shkrim nga dërguesi, transportuesi, marrësi ose subjekti që kërkon kryerjen e transportit, pranë autoritetit që lëshon autorizimin sipas nenit 41 të këtij ligji.

2. Kërkesa për autorizim përmban:

a) të dhënat identifikuese të kërkuarit, dërguesit, transportuesit dhe marrësit;

b) të dhënat për mallrat që do të transportohen, përfshirë numrin UN, emërtimin, klasifikimin, sasinë, gjendjen fizike dhe mënyrën e ambalazhimit ose mbajtjes;

c) vendin e nisjes, vendin e mbërritjes, itinerarin dhe, kur është rasti, pikat e kalimit kufitar;

ç) datën ose periudhën kur kërkohet të kryhet transporti;

d) të dhënat për mjetin rrugor, vagonin, cisternën, kontejnerin, ambalazhin ose pajisjen tjetër që do të përdoret për transport;

dh) të dhënat për drejtuesin ose drejtuesit e mjeteve, kur transporti kryhet me rrugë;

e) dokumentet, certifikatat, miratimet, pëlqimet ose njoftimet që kërkohen sipas ADR-së, RID-it, këtij ligji ose legjislacionit përkatës në fuqi;

ë) masat e sigurisë, shoqërimit, mbrojtjes fizike, mbrojtjes nga rrezatimet, ndërhyrjes emergjente ose masat e tjera të posaçme, kur këto janë të nevojshme për llojin e mallrave ose kushtet e transportit;

f) autorizimet ose pëlqimet e autoriteteve të shteteve të tjera, kur këto kërkohen për importin, eksportin ose transitin.

3. Për autorizimin e një transporti të vetëm, kërkesa përcakton datën ose periudhën brenda së cilës do të kryhet transporti. Periudha e autorizuar nuk mund të jetë më e gjatë se 15 ditë nga data e parashikuar për fillimin e transportit.

4. Autoriteti që lëshon autorizimin sipas nenit 41 të këtij ligji mund të kërkojë plotësimin e dokumentacionit ose informacion shtesë vetëm kur ky është i nevojshëm për vlerësimin e sigurisë së transportit, përputhshmërinë me ADR-në ose RID-in, ose përmbushjen e kërkesave për llojin përkatës të mallrave.

5. Kur kërkesa nuk është e plotë, autoriteti që lëshon autorizimin sipas nenit 41 të këtij ligji njofton kërkuesin për plotësimin e saj, në përputhje me rregullat e procedurës administrative.

Neni 43

Lëshimi dhe përmbajtja e autorizimit

1. Autoriteti që lëshon autorizimin sipas nenit 41 të këtij ligji e lëshon autorizimin kur vlerëson se transporti mund të kryhet në përputhje me këtë ligj, ADR-në ose RID-in dhe masat e nevojshme të sigurisë.

2. Autorizimi përmban, sipas rastit:

a) subjektin e autorizuar;

b) llojin dhe sasinë e mallrave që lejohen të transportohen;

c) mënyrën e transportit;

ç) vendin e nisjes, vendin e mbërritjes, itinerarin dhe pikat e kalimit kufitar;

d) datën, periudhën ose afatin e vlefshmërisë së autorizimit;

dh) mjetin rrugor, vagonin, cisternën, kontejnerin, ambalazhin ose pajisjen tjetër të transportit, kur këto përcaktohen si kushte të autorizimit;

e) drejtuesin ose drejtuesit e mjeteve, kur transporti kryhet me rrugë dhe këto të dhëna kërkohen për arsye sigurie;

ë) kushtet për njoftimin paraprak të autoriteteve kompetente;

f) kushtet për shoqërimin, ndalimin, qëndrimin, parkimin, kalimin, mbrojtjen fizike ose masa të tjera të sigurisë.

3. Autorizimi mbahet gjatë transportit dhe paraqitet menjëherë kur kërkohet nga autoritetet kompetente.

4. Autorizimi nuk transferohet te një subjekt tjetër.

5. Transporti kryhet vetëm brenda afatit dhe kushteve të përcaktuara në autorizim.

Neni 44

Autorizimi për transporte të përsëritura

1. Për transporte të përsëritura të lëndëve plasëse ose materialeve radioaktive mund të lëshohet autorizim i vetëm për më shumë se një transport.

2. Autorizimi për transporte të përsëritura lëshohet vetëm kur transportet kryhen nga i njëjti subjekt, për të njëjtin lloj mallrash, në të njëjtin itinerar dhe në kushte të njëjta ose të krahasueshme sigurie.

3. Autorizimi për transporte të përsëritura jepet vetëm kur përsëritja e transportit nuk cenon sigurinë publike, mbrojtjen nga rrezatimet, sigurinë e transportit, pronën ose mjedisin.

4. Autorizimi për transporte të përsëritura është i vlefshëm:

a) deri në një muaj, për lëndët plasëse;

b) deri në gjashtë muaj, për materialet radioaktive.

5. Çdo ndryshim i mallrave, sasisë, itinerarit, afatit, mjetit, drejtuesit të mjetit ose kushteve të tjera të autorizimit njoftohet paraprakisht pranë autoritetit që ka lëshuar autorizimin dhe kryhet vetëm pas miratimit të tij.

Neni 45 **Njoftimet paraprake**

1. Për transportin e lëndëve plasëse, subjekti i autorizuar njofton me shkrim Policinë e Shtetit jo më vonë se 24 orë përpara fillimit të transportit.

2. Njoftimi sipas pikës 1 të këtij neni përmban vendin e nisjes, itinerarin, vendin e mbërritjes, kohën e saktë të fillimit dhe kohën e parashikuar të përfundimit të transportit, mjetin ose mjetet e transportit dhe drejtuesin ose drejtuesit e mjeteve.

3. Policia e Shtetit, pas marrjes së njoftimit, njofton strukturat e saj vendore përgjatë itinerarit të transportit dhe, kur është rasti, strukturën e policisë kufitare në pikën ku kryhet importimi, eksportimi ose kalimi transit.

4. Për transportin e materialeve radioaktive ose materialeve bërthamore, subjekti i autorizuar njofton, jo më vonë se 24 orë përpara fillimit të transportit, autoritetin që ka lëshuar autorizimin.

5. Kur për arsye sigurie, emergjence, force madhore ose rrethanash të paparashikuara ndryshon koha e fillimit, koha e përfundimit, itinerari, mjeti ose kusht tjetër i transportit, subjekti i autorizuar njofton menjëherë autoritetin që ka lëshuar autorizimin dhe autoritetet e tjera të përcaktuara në autorizim.

Neni 46 **Kufizimet dhe ndalimet e posaçme për arsye sigurie**

1. Për arsye të sigurisë publike, mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të njerëzve, mbrojtjes së mjedisit, sigurisë rrugore, sigurisë hekurudhore, mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese, sigurisë bërthamore ose mbrojtjes civile, autoriteti që lëshon autorizimin sipas nenit 41 të këtij ligji, Policia Rrugore ose Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore, sipas rastit dhe fushës së përgjegjësisë, mund të vendosin kufizime ose ndalime të posaçme për kryerjen e transportit të mallrave të rrezikshme.

2. Kufizimet ose ndalimet sipas pikës 1 të këtij neni mund të lidhen me itinerarin, kohën e transportit, vendin e ndalimit ose parkimit, kalimin në zona të caktuara, përdorimin e infrastrukturës, shoqërimin, njoftimin paraprak ose masa të tjera të nevojshme sigurie.

3. Kufizimet ose ndalimet duhet të jenë të arsyetuara, proporcionale me rrezikun dhe të kufizuara në masën dhe kohën e nevojshme për shmangien ose uljen e rrezikut.

4. Kufizimet ose ndalimet sipas këtij neni kanë karakter operativ ose organizativ dhe nuk ndryshojnë kërkesat teknike të ADR-së ose RID-it për klasifikimin, ambalazhimin, shënimin, etiketimin, cisternat, mjetet ose vagonët, përveç kur kjo lejohet shprehimisht nga ADR-ja ose RID-i.

5. Autoriteti që vendos kufizimin ose ndalimin njofton subjektin ndaj të cilit zbatohet masa dhe, kur është e nevojshme, autoritetet e tjera kompetente që lidhen me kryerjen e transportit.

Neni 47 **Autorizimet për raste përjashtimore dhe përjashtimet nga ADR-ja ose RID-i**

1. Për raste të veçanta dhe të justifikuara, ministri përgjegjës për transportin mund të autorizojë kryerjen në territorin e Republikës së Shqipërisë të një operacioni transporti të mallrave të rrezikshme që nuk lejohet sipas ADR-së ose RID-it, ose kryerjen e tij në kushte të ndryshme nga ato të ADR-së ose RID-it.

2. Kërkesa për autorizim sipas pikës 1 të këtij neni paraqitet me shkrim pranë ministritë përgjegjëse për transportin nga dërguesi, transportuesi, marrësi ose subjekti që kërkon kryerjen e transportit.

3. Kërkesa për autorizim përmban të paktën:

- a) arsyetimin e rastit përjashtimor;
- b) të dhënat për subjektin që kërkon kryerjen e transportit;

c) të dhënat për mallrat që do të transportohen, përfshirë numrin UN, emërtimin, klasifikimin, sasinë dhe mënyrën e ambalazhimit ose mbajtjes;

ç) mënyrën e transportit, itinerarin, vendin e nisjes, vendin e mbërritjes dhe periudhën e kryerjes së transportit;

d) kërkesat e ADR-së ose RID-it nga të cilat kërkohet shmangia ose kushtet e ndryshme që kërkohet të zbatohen;

dh) masat teknike, operative, organizative, të shoqërimit, mbikëqyrjes, njoftimit dhe ndërhyrjes emergjente që propozohen për garantimin e sigurisë;

e) dokumentet, certifikatat, miratimet ose autorizimet e tjera që lidhen me mallrat ose operacionin e transportit, kur ato kërkohen sipas legjislacionit të posaçëm.

4. Ministria përgjegjëse për transportin, përpara dhënies së autorizimit, merr mendimin e Policisë Rrugore për transportin rrugor, të Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore për transportin hekurudhor dhe të autoriteteve të përcaktuara në nenin 41 të këtij ligji, sipas llojit të mallrave.

5. Për lëndët plasëse, autorizimi sipas këtij neni jepet vetëm pas pëlqimit të Policisë së Shtetit. Për materialet radioaktive ose materialet bërthamore, autorizimi jepet vetëm pas pëlqimit të autoriteteve përgjegjëse sipas legjislacionit për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe sigurinë bërthamore.

6. Ministri përgjegjës për transportin vendos për lëshimin ose refuzimin e autorizimit sipas këtij neni brenda 30 ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës së plotë. Kur për dhënien e autorizimit kërkohet mendim ose pëlqim nga autoritete të tjera kompetente, ministria përgjegjëse për transportin kërkon marrjen e tij brenda këtij afati. Mosdhënia e mendimit brenda afatit nuk pengon vendimmarrjen, përveç rasteve kur, sipas këtij ligji ose legjislacionit të posaçëm, kërkohet pëlqim i detyrueshëm. Vendimi për lëshimin ose refuzimin e autorizimit jepet me akt të arsyetuar.

7. Autorizimi sipas këtij neni jepet vetëm kur operacioni i transportit është i përcaktuar qartë, i kufizuar në kohë dhe kur masat e propozuara sigurojnë që siguria e transportit të mos cenohet.

8. Autorizimi përcakton subjektin e autorizuar, mallrat që transportohen, sasinë, mënyrën e transportit, itinerarin, afatin e vlefshmërisë, mjetin rrugor ose vagonin, ambalazhin, cisternën ose pajisjen që përdoret, kushtet e shoqërimit, njoftimit, mbikëqyrjes, ndërhyrjes emergjente dhe çdo masë tjetër të nevojshme sigurie.

9. Autorizimi sipas këtij neni nuk transferohet te një subjekt tjetër dhe nuk mund të përdoret për krijimin e një regjimi të përgjithshëm ose të përhershëm transporti në kushte të ndryshme nga ADR-ja ose RID-i.

10. Përjashtimet me karakter të përgjithshëm nga ADR-ja ose RID-i, për transportin e mallrave të rrezikshme brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, mund të kërkohen vetëm kur siguria e transportit nuk cenohet dhe vetëm për rastet e mëposhtme:

a) transportin e sasive të vogla të mallrave të caktuara të rrezikshme, me përjashtim të substancave që kanë nivel mesatar ose të lartë radioaktiviteti, me kusht që kushtet për këtë transport të mos jenë më të rrepta se kushtet e përcaktuara në ADR ose RID;

b) transportin lokal në distanca të shkurtra;

c) transportin lokal hekurudhor në itinerare të posaçme të përcaktuara, që përbëjnë pjesë të një procesi industrial të përcaktuar dhe kontrollohen ngushtë në kushte të përcaktuara qartë.

11. Kërkesa për autorizimin ose zgjatjen e autorizimit të përjashtimeve me karakter të përgjithshëm sipas pikës 10 të këtij neni, si dhe zbatimi i tyre, kryhen sipas nenit 67, pikat 3, 4 dhe 5, të këtij ligji.

Neni 48

Refuzimi, pezullimi dhe revokimi i autorizimit

1. Autoriteti që ka lëshuar autorizimin refuzon lëshimin e autorizimit kur nuk plotësohen kërkesat e këtij ligji, ADR-së ose RID-it, ose kur transporti nuk mund të kryhet në mënyrë të sigurt.

2. Autoriteti që ka lëshuar autorizimin pezullon ose revokon autorizimin kur:

a) autorizimi është lëshuar mbi bazën e të dhënave të pasakta ose të rreme;

b) subjekti i autorizuar shkel kushtet e autorizimit;

c) ndryshojnë rrethanat mbi bazën e të cilave është lëshuar autorizimi;

ç) vijimi i transportit paraqet rrezik për sigurinë e transportit, sigurinë publike, mbrojtjen civile, mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese, sigurinë bërthamore, njerëzit, pronën ose mjedisin.

3. Kur mospërputhja mund të korrigjohet pa cenuar sigurinë, autoriteti që ka lëshuar autorizimin mund t'i caktojë subjektit një afat për korrigjimin e saj.

4. Pezullimi ose revokimi i autorizimit i njoftohet menjëherë subjektit të autorizuar dhe autoriteteve kompetente që lidhen me kryerjen e transportit.

5. Kur autorizimi pezullohet ose revokohet gjatë kryerjes së transportit, subjekti i autorizuar, transportuesi dhe autoriteti që ka lëshuar autorizimin marrin masat e nevojshme për ndalimin e sigurt të transportit, sigurimin e ngarkesës dhe parandalimin e rrezikut për njerëzit, pronën dhe mjedisin.

6. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për transportin, përcakton me vendim rregullat e hollësishme për autorizimet sipas këtij kreu, të cilat përfshijnë:

a) procedurën për paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesës, dokumentacionin shoqërues dhe afatet përkatëse;

b) lëshimin, refuzimin, rinovimin, pezullimin, revokimin dhe zëvendësimin e autorizimit;

c) tarifatat për shqyrtimin e kërkesës, lëshimin, rinovimin dhe zëvendësimin e autorizimit.

KREU VI

KONTROLI I TRANSPORTIT RRUGOR TË MALLRAVE TË RREZIKSHME

Neni 49

Fusha dhe qëllimi i kontrollit rrugor

1. Ky kre zbatohet për kontrollin e transportit rrugor të mallrave të rrezikshme me mjete që qarkullojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë ose hyjnë në territorin e saj nga një shtet tjetër.

2. Ky kre nuk zbatohet për transportin e mallrave të rrezikshme me mjete që i përkasin ose janë nën përgjegjësinë e Forcave të Armatosura, sipas nenit 3 të këtij ligji.

3. Kontrollat sipas këtij kreu kryhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me këtë ligj, ADR-në, legjislacionin në fuqi për qarkullimin rrugor, legjislacionin doganor dhe kufitar, si dhe rregullat e tjera të zbatueshme për kontrollin e transportit rrugor.

4. Kontrolli rrugor kryhet nga Policia e Shtetit, nëpërmjet strukturave të Policisë Rrugore, dhe, sipas fushës së përgjegjësisë, me mbështetjen e autoriteteve të tjera kompetente të përcaktuara në këtë ligj.

5. Autoritetet kompetente sigurojnë që një pjesë përfaqësuese e dërgesave të mallrave të rrezikshme të transportuara me rrugë t'u nënshtrohet kontrolleve të parashikuara në këtë kre, me qëllim verifikimin e përputhjes së tyre me legjislacionin për transportin rrugor të mallrave të rrezikshme.

6. Kontrollat rrugore kryhen në mënyrë të rastësishme dhe, për aq sa është e mundur, mbulojnë një pjesë të gjerë të rrjetit rrugor.

7. Autoritetet kompetente mund të kryejnë edhe masa ose kontrolle më të hollësishme për transportin rrugor të mallrave të rrezikshme, kur kjo është e nevojshme sipas këtij ligji, ADR-së ose legjislacionit përkatës në fuqi.

8. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për transportin, përcakton me vendim rregullat e hollësishme teknike për kontrollin rrugor të transportit të mallrave të rrezikshme, të cilat përfshijnë:

a) formatin standard të listës së kontrollit të përdorur për kryerjen e kontrolleve sipas nenit 51, pika 1, të këtij ligji, si dhe formatin e dokumentit që vërteton rezultatin e kontrollit sipas nenit 51, pika 2, të këtij ligji;

b) listën jo shteruese të shkeljeve dhe ndarjen e tyre sipas kategorive të rrezikut, për qëllime kontrolli, dokumentimi, masash dhe raportimi;

c) formatin standard të raportimit për kontrollat rrugore të transportit të mallrave të rrezikshme;

ç) mënyrën teknike të dokumentimit të kontrollit, përcjelljes së të dhënave, administrimit të informacionit dhe raportimit nga autoritetet kompetente;

d) rregulla të tjera teknike të nevojshme për zbatimin e këtij kreu, pa cenuar kompetencat, masat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 50

Përkufizime për qëllime të këtij kreu

Për qëllime të këtij kreu, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Kontroll rrugor” është kontrolli i kryer nga autoritetet kompetente ndaj transportit rrugor të mallrave të rrezikshme, në përputhje me këtë ligj, ADR-në dhe këtë kre.
2. “Listë kontrolli” është formulari standard që përdoret gjatë kontrollit rrugor të transportit të mallrave të rrezikshme.
3. “Mallra të rrezikshme” janë mallrat e rrezikshme sipas kuptimit të dhënë në nenin 1, shkronja “b”, të Marrëveshjes ADR, të lidhur në Gjenevë më 30 shtator 1957, dhe në anekset A dhe B të kësaj marrëveshjeje, siç referohen në këtë ligj.
4. “Mjet rrugor” është çdo mjet motorik i destinuar për përdorim në rrugë, i plotë ose jo i plotë, që ka të paktën katër rrota dhe shpejtësi maksimale të projektuar mbi 25 km/orë, së bashku me rimorkiot e tij, me përjashtim të mjeteve që lëvizin mbi shina, traktorëve bujqësorë dhe pyjorë dhe makinerive të lëvizshme.
5. “Transport rrugor” është çdo operacion transporti rrugor i kryer me mjet rrugor, tërësisht ose pjesërisht në rrugë publike brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për transportin e mallrave të rrezikshme, përfshirë ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave që mbulohen nga ky ligj.
6. “Subjekt i kontrollit” është çdo person fizik ose juridik, pavarësisht nëse ushtron veprimtari fitimprurëse ose jo, çdo bashkim ose grup personash pa personalitet juridik, pavarësisht nëse ushtron veprimtari fitimprurëse ose jo, si dhe çdo organ që i përket një autoriteti publik, pavarësisht nëse ka personalitet juridik ose varet nga një autoritet që ka personalitet juridik, i cili kryen, ngarkon ose shkarkon mallra të rrezikshme, shkarkon kryerjen e transportit të tyre, ose që, si pjesë e një operacioni transporti, i ruan përkohësisht, i mbledh, i ambalazhon ose i merr në dorëzim këto mallra dhe ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 51

Mënyra e kryerjes së kontrollit rrugor

1. Për kryerjen e kontrolleve të parashikuara në këtë kre përdoret lista e kontrollit sipas formatit standard të miratuar në zbatim të nenit 49, pika 8, shkronja “a”, të këtij ligji.
2. Një kopje e listës së kontrollit ose e dokumentit që vërteton rezultatin e kontrollit, sipas formatit standard të miratuar në zbatim të nenit 49, pika 8, shkronja “a”, të këtij ligji, i jepet drejtuesit të mjetit rrugor nga autoriteti që ka kryer kontrollin.
3. Lista e kontrollit ose dokumenti që vërteton rezultatin e kontrollit paraqitet nga drejtuesi i mjetit rrugor, kur kërkohet nga autoritetet kompetente, me qëllim lehtësimin ose shmangien, kur është e mundur, të kontrolleve të mëvonshme.
4. Pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni nuk cenojnë të drejtën e autoriteteve kompetente për të kryer masa ose kontrolle të posaçme më të hollësishme, kur kjo është e nevojshme për verifikimin e sigurisë së transportit.
5. Vendet e zgjedhura për kryerjen e kontrollit rrugor duhet të mundësojnë sjelljen e mjetit në përputhje me kërkesat e zbatueshme ose, kur autoriteti që kryen kontrollin e vlerëson të përshtatshme, ndalimin e tij në vend ose në një vend tjetër të caktuar për këtë qëllim, pa shkaktuar rrezik për sigurinë.
6. Kur është e përshtatshme dhe me kusht që kjo të mos përbëjë rrezik për sigurinë, mund të merren mostra të mallrave të transportuara për ekzaminim nga laboratorë të njohur nga autoriteti kompetent ose të akredituar sipas legjislacionit në fuqi.
7. Kontrolli rrugor nuk zgjat më shumë se koha e arsyeshme e nevojshme për kryerjen e verifikimeve përkatëse.

Neni 52

Masat gjatë kontrollit rrugor

1. Kur gjatë kontrollit konstatohet një ose më shumë shkelje e rregullave për transportin rrugor të mallrave të rrezikshme, veçanërisht shkelje të përcaktuara në listën jo shteruese të miratuar në zbatim

të nenit 49, pika 8, shkronja “b”, të këtij ligji, Policia Rrugore, pa cenuar sanksionet e tjera që mund të vendosen, merr masat e nevojshme në varësi të rrethanave, kategorisë së rrezikut të shkeljes dhe kërkesave të sigurisë.

2. Për qëllime të kontrollit, dokumentimit, raportimit dhe vendosjes së masave sipas këtij kreu, shkeljet e konstatuara gjatë kontrollit rrugor klasifikohen në kategoritë e rrezikut I, II dhe III.

3. Kategoria e rrezikut I përfshin shkeljet që krijojnë rrezik të lartë për vdekje, dëmtim të rëndë të personave ose dëmtim të konsiderueshëm të mjedisit dhe zakonisht kërkojnë masa të menjëhershme korrigjuese, përfshirë, kur është rasti, ndalimin e mjetit.

4. Kategoria e rrezikut II përfshin shkeljet që krijojnë rrezik për dëmtim të personave ose dëmtim të mjedisit dhe zakonisht kërkojnë masa korrigjuese të përshtatshme, nëse është e mundur dhe e përshtatshme në vendin e kontrollit, ose jo më vonë se përfundimi i transportit në vijim.

5. Kategoria e rrezikut III përfshin shkeljet që krijojnë rrezik të ulët për dëmtim të personave ose dëmtim të mjedisit dhe për të cilat masat korrigjuese mund të merren në një moment të mëvonshëm.

6. Kur shkelja mund të cenojë sigurinë e transportit, Policia Rrugore mund:

- a) të ndalojë vijimin e transportit;
 - b) të ndalojë mjetin në vend ose në një vend tjetër të caktuar për këtë qëllim nga autoriteti që kryen kontrollin;
 - c) të kërkojë sjelljen e transportit në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe ADR-së përpara vijimit të udhëtimit;
 - ç) të urdhërojë marrjen e masave për sigurimin, transferimin, shkarkimin, rregullimin, pastrimin ose dekontaminimin e ngarkesës, kur këto masa mund të kryhen pa rrezik;
 - d) të kërkojë ndërhyrjen ose ndihmën e autoriteteve të tjera kompetente;
 - dh) të njoftojë autoritetin që ka lëshuar autorizimin, certifikatën ose miratimin përkatës;
 - e) të marrë masa të tjera të përshtatshme në varësi të rrethanave ose kërkesave të sigurisë.
7. Kur mjeti hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë nga një shtet tjetër dhe shkelja e konstatuar cenon sigurinë e transportit, Policia Rrugore, në bashkëpunim me autoritetet doganore ose autoritetet kompetente kufitare, mund të refuzojë hyrjen e tij në territor deri në korrigjimin e shkeljes ose marrjen e masave të tjera të përshtatshme.
8. Transporti mund të vijojë vetëm pasi shkelja që cenon sigurinë të jetë korrigjuar ose pasi Policia Rrugore të ketë përcaktuar kushtet për vijimin e udhëtimit në mënyrë të sigurt.
9. Kur konstatohet më shumë se një shkelje për të njëjtën njësi transporti, për qëllime raportimi zbatohet vetëm kategoria më e rëndë e rrezikut.

Neni 53

Kontrolli në mjediset e subjekteve të kontrollit

1. Kontrolli mund të kryhet edhe në mjediset e subjekteve të kontrollit, ku kryhen ose administrohen veprimtari të lidhura drejtpërdrejt me transportin rrugor të mallrave të rrezikshme, nga Policia Rrugore dhe, sipas objektit të kontrollit, nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, autoritetet doganore ose autoritetet përgjegjëse sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi.

2. Kontrolli sipas pikës 1 të këtij neni kryhet:

- a) si masë parandaluese; ose
- b) kur gjatë kontrollit rrugor janë konstatuar shkelje që cenojnë sigurinë e transportit të mallrave të rrezikshme.

3. Qëllimi i kontrollit në mjediset e subjekteve të kontrollit është të sigurohet që kushtet e sigurisë për transportin rrugor të mallrave të rrezikshme të jenë në përputhje me këtë ligj dhe ADR-në.

4. Kur në mjediset e subjektit të kontrollit konstatohet një ose më shumë shkelje që lidhen me transportin rrugor të mallrave të rrezikshme, veçanërisht shkelje të përcaktuara në listën jo shteruese të miratuar në zbatim të nenit 49, pika 8, shkronja “b”, të këtij ligji, transporti përkatës vihet në përputhje përpara se mallrat të largohen nga këto mjedise ose i nënshtrohet masave të tjera të përshtatshme.

5. Gjatë kontrollit në mjediset e subjekteve të kontrollit mund të verifikohen vetëm dokumentet, veprimtaritë, pajisjet, ambalazhet, cisternat, mjetet, kontejnerët, raportet, të dhënat dhe masat e sigurisë që lidhen drejtpërdrejt me transportin rrugor të mallrave të rrezikshme.

6. Subjektet e kontrollit u japin autoriteteve kompetente informacionin, dokumentet dhe aksesin e nevojshëm për kryerjen e kontrollit, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 54

Shkëmbimi i informacionit dhe ndihma e ndërsjellë

1. Republika e Shqipërisë, nëpërmjet strukturës përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme dhe autoriteteve të tjera kompetente, bashkëpunon dhe shkëmben informacion me autoritetet kompetente të shteteve të tjera për zbatimin e këtij kreu dhe për sigurimin e zbatimit efektiv të rregullave për kontrollin rrugor të transportit të mallrave të rrezikshme.

2. Kur konstatohen shkelje serioze ose të përsëritura që cenojnë sigurinë e transportit të mallrave të rrezikshme dhe që janë kryer nga një mjet i regjistruar në një shtet tjetër ose nga një subjekt që ka selinë në një shtet tjetër, autoriteti që ka konstatuar shkeljen i përcjell informacionin strukturës përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme.

3. Struktura përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme, sipas rastit, njofton autoritetet kompetente të shtetit ku është regjistruar mjeti ose ku subjekti ka selinë, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe.

4. Kur shkelje serioze ose të përsëritura janë konstatuar në territorin e Republikës së Shqipërisë, struktura përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme mund të kërkojë nga autoritetet kompetente të shtetit ku është regjistruar mjeti ose ku subjekti ka selinë marrjen e masave të përshtatshme ndaj shkelësit ose shkelësve.

5. Kur autoritetet kompetente shqiptare marrin njoftim nga një shtet tjetër për shkelje serioze ose të përsëritura të kryera nga mjet i regjistruar në Republikën e Shqipërisë ose nga subjekt që ka selinë në Republikën e Shqipërisë, ato shqyrtojnë rastin, marrin masat përkatëse sipas kompetencës dhe njoftojnë autoritetin që ka përcjellë informacionin për masat e marra.

6. Kur rezultatet e kontrollit rrugor ndaj një mjeti të regjistruar në një shtet tjetër japin arsye për të besuar se janë kryer shkelje serioze ose të përsëritura, të cilat nuk mund të verifikohen gjatë këtij kontrolli për shkak të mungesës së të dhënave të nevojshme, autoritetet kompetente, nëpërmjet strukturës përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme, bashkëpunojnë me autoritetet kompetente të shtetit përkatës për sqarimin e rastit.

7. Kur, për sqarimin e rastit sipas pikës 6 të këtij neni, kryhet kontroll në mjediset e subjektit të kontrollit në Republikën e Shqipërisë, struktura përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme njofton autoritetet kompetente të shteteve të tjera të interesuara për rezultatet e kontrollit.

Neni 55

Dokumentimi i kontrolleve rrugore

1. Autoriteti që kryen kontrollin dokumenton rezultatet e kontrollit, shkeljet e konstatuara, kategorinë e rrezikut, masat e marra dhe, kur është rasti, sanksionet e vendosura.

2. Dokumentimi i kontrollit kryhet nëpërmjet listës së kontrollit ose dokumentit që vërteton rezultatin e kontrollit, sipas formatit standard të miratuar në zbatim të nenit 49, pika 8, shkronja “a”, të këtij ligji.

3. Autoritetet që kryejnë kontrolle rrugore i përcjellin strukturës përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme, sipas afateve dhe formatit të përcaktuar në aktin nënligjor të miratuar në zbatim të nenit 49, pika 8, shkronja “c”, të këtij ligji, të dhënat për kontrollet, shkeljet, kategoritë e rrezikut, masat dhe sanksionet e vendosura.

4. Të dhënat e përcjella sipas pikës 3 të këtij neni përdoren për monitorimin e zbatimit të këtij ligji, përgatitjen e raportit kombëtar sipas nenit 56 të këtij ligji dhe shkëmbimin e informacionit me autoritetet kompetente të shteteve të tjera sipas nenit 54 të këtij ligji.

Neni 56

Raportimi për kontrollet rrugore

1. Struktura përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme përgatit projekt-raportin kombëtar për kontrollet rrugore të transportit të mallrave të rrezikshme, mbi bazën e të dhënave të përcjella nga autoritetet që kryejnë kontrolle rrugore.

2. Autoritetet që kryejnë kontrolle rrugore janë përgjegjëse për saktësinë dhe plotësinë e të dhënave që i përcjellin strukturës përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme.

3. Raporti kombëtar miratohet nga ministria përgjegjëse për transportin.

4. Raporti kombëtar përmban të paktën:

- a) numrin e kontrolleve të kryera;
- b) numrin e mjeteve të kontrolluara, sipas vendit të regjistrimit;
- c) numrin e njërive të transportit që nuk janë në përputhje me ADR-në;
- ç) numrin e njërive të transportit të ndaluara;
- d) numrin e shkeljeve të konstatuara sipas kategorive të rrezikut;
- dh) llojin dhe numrin e sanksioneve të vendosura.

5. Për qëllime të raportimit sipas këtij neni, vendi i regjistrimit është vendi i regjistrimit të mjetit motorik.

6. Pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ministria përgjegjëse për transportin i dërgon Komisionit Evropian raportin përmbledhës për kontrollet rrugore të transportit të mallrave të rrezikshme çdo dy vjet, jo më vonë se 12 muaj pas përfundimit të vitit të dytë, sipas formatit dhe mënyrës teknike të raportimit të përcaktuara në zbatim të nenit 49, pika 8, shkronja “c”, të këtij ligji.

KREU VII

MBIKËQYRJA E TRANSPORTIT HEKURUDHOR TË MALLRAVE TË RREZIKSHME

Neni 57

Kontrolli i transportit hekurudhor të mallrave të rrezikshme

1. Kontrolli i transportit hekurudhor të mallrave të rrezikshme kryhet për të verifikuar përputhjen me këtë ligj dhe RID-in.

2. Kontrolli sipas pikës 1 të këtij neni kryhet nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore, brenda fushës së përgjegjësisë për sigurinë dhe ndërveprimin hekurudhor.

3. Kontrolli mund të kryhet në tren, vagon, stacion, terminal, vend ngarkimi, vend shkarkimi, degëzim hekurudhor, impiant shërbimi ose në mjedise të tjera ku kryhen veprimtari të lidhura drejtpërdrejt me transportin hekurudhor të mallrave të rrezikshme.

4. Gjatë kontrollit verifikohen, sipas rastit:

- a) dokumentet e transportit dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas këtij ligji dhe RID-it;
- b) lejimi i mallrave të rrezikshme për transport hekurudhor;
- c) përputhja e vagonit, vagonit-cisternë, cisternës, kontejnerit, ambalazhit ose pajisjes tjetër të transportit me kërkesat e zbatueshme;
- ç) shënimi, etiketimi, vendosja e pllakave-etiketa, panelet portokalli ose shenjat e tjera të rrezikut, kur këto kërkojnë sipas RID-it;
- d) ngarkimi, vendosja, sigurimi, ndarja, mbushja, shkarkimi dhe trajtimi i mallrave të rrezikshme;
- dh) përmbushja e detyrimeve të pjesëmarrësve në transport, këshilltarit të sigurisë dhe personelit të përfshirë në transportin hekurudhor të mallrave të rrezikshme;
- e) zbatimi i kushteve të autorizimit të posaçëm, kur transporti kryhet me autorizim sipas këtij ligji;
- ë) masat e sigurisë dhe masat për mbrojtjen ndaj keqpërdorimit të qëllimshëm, kur kërkojnë sipas RID-it.

5. Sipërmarrësi hekurudhor, administruesi i infrastrukturës, operatori i impiantit të shërbimit, subjekti përgjegjës për mirëmbajtjen dhe pjesëmarrësit e tjerë në transport i japin Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore informacionin, dokumentet dhe aksesin e nevojshëm për kryerjen e kontrollit, për aq sa lidhet drejtpërdrejt me transportin hekurudhor të mallrave të rrezikshme.

Neni 58

Masat gjatë kontrollit në transportin hekurudhor

1. Kur gjatë kontrollit konstatohet mospërputhje me këtë ligj ose RID-in, Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore kërkon korrigjimin e saj brenda një afati të përshtatshëm, kur mospërputhja nuk cenon menjëherë sigurinë e transportit.

2. Kur mospërputhja mund të cenojë sigurinë e transportit hekurudhor të mallrave të rrezikshme, Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore, sipas rastit, mund:

- a) të ndalojë nisjen ose vijimin e transportit;
- b) të kërkojë ndalimin, veçimin, zhvendosjen ose mbajtjen e vagonit, vagonit-cisternë, cisternës, kontejnerit ose ngarkesës në një vend të sigurt;
- c) të kërkojë marrjen e masave për sigurimin, rregullimin, transferimin, shkarkimin, pastrimin ose dekontaminimin e ngarkesës, kur këto masa mund të kryhen pa rrezik;
- ç) të kërkojë nga sipërmarrësi hekurudhor, administruesi i infrastrukturës ose operatori përkatës marrjen e masave të nevojshme për sigurinë e qarkullimit hekurudhor;
- d) të kërkojë ndërhyrjen ose ndihmën e autoriteteve të tjera kompetente;
- dh) të njoftojë autoritetin që ka lëshuar autorizimin, miratimin ose dokumentin përkatës;
- e) të marrë masa të tjera të nevojshme për parandalimin ose kufizimin e rrezikut.

3. Sipërmarrësi hekurudhor, administruesi i infrastrukturës dhe pjesëmarrësit e tjerë në transport nuk lejojnë nisjen, vijimin ose pranimin për transport të mëtejshëm të vagonit, cisternës, kontejnerit ose ngarkesës, derisa mospërputhja që cenon sigurinë të jetë korrigjuar ose derisa Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore të ketë përcaktuar kushtet për vijimin e sigurt të transportit.

4. Kur mospërputhja lidhet me kushtet e certifikatës së sigurisë, autorizimit të sigurisë, sistemit të menaxhimit të sigurisë ose masave të kontrollit të rrezikut, Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore vepron sipas kompetencave të tij në fushën e sigurisë hekurudhore.

5. Masat e marra sipas këtij neni dokumentohen sipas legjislacionit për sigurinë hekurudhore dhe, kur lidhen me transportin e mallrave të rrezikshme, të dhënat përkatëse i përcillen strukturës përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme pranë ministrisë përgjegjëse për transportin, për qëllime bashkërendimi dhe monitorimi.

6. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore merr masat që i takojnë për sigurinë hekurudhore dhe njofton autoritetin përgjegjës për investigimin teknik, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

KREU VIII

AKSIDENTET, INCIDENTET DHE RAPORTIMI

Neni 59

Njoftimi i aksidentit, incidentit ose rrezikut të menjëhershëm

1. Në rast aksidenti, incidenti, derdhjeje, rrjedhjeje, humbjeje të mallrave të rrezikshme ose rreziku të menjëhershëm gjatë transportit, ngarkimit, mbushjes, shkarkimit ose veprimtarive të tjera të lidhura drejtpërdrejt me transportin e mallrave të rrezikshme, pjesëmarrësi që e konstaton ngjarjen njofton menjëherë numrin e unifikuar të thirrjeve emergjente 112.

2. Njoftimi sipas pikës 1 të këtij neni përmban, për aq sa është e mundur, të dhëna për:

- a) vendndodhjen e ngjarjes;
- b) llojin e ngjarjes dhe rrezikun e krijuar;
- c) numrin UN, emërtimin dhe klasën e mallrave të rrezikshme, kur këto të dhëna janë të disponueshme;
- ç) sasinë e përafërt të mallrave të përfshira;
- d) praninë e derdhjes, rrjedhjes, zjarrit, shpërthimit ose dëmtimit të ambalazhit, cisternës, vagonit, mjetit ose kontejnerit;
- dh) rrezikun për njerëzit, pronën, mjedisin ose infrastrukturën;
- e) masat fillestare të marra.

3. Kur ngjarja përfshin materiale radioaktive, materiale bërthamore ose lëndë plasëse, njoftohen edhe autoritetet përgjegjëse për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese, sigurinë bërthamore ose lëndët plasëse për përdorim civil, sipas rastit, si dhe autoritetet e përcaktuara në kushtet e autorizimit.

4. Në rast aksidenti ose incidenti në transportin hekurudhor të mallrave të rrezikshme, njoftohen edhe autoritetet kompetente sipas legjislacionit për sigurinë hekurudhore dhe investigimin e aksidenteve dhe incidenteve hekurudhore.

Neni 60

Masat fillestare dhe bashkëpunimi me autoritetet kompetente

1. Pjesëmarrësit në transport marrin menjëherë masat fillestare të nevojshme, për aq sa kjo mund të kryhet pa rrezik, për të kufizuar pasojat e aksidentit, incidentit, derdhjes, rrjedhjes, humbjes së mallrave të rrezikshme ose rrezikut të menjëhershëm.

2. Masat fillestare merren në përputhje me këtë ligj, ADR-në ose RID-in, udhëzimet me shkrim, dokumentet e transportit dhe kushtet e autorizimit, kur këto zbatohen.

3. Pjesëmarrësit në transport i japin autoriteteve kompetente dhe strukturave që ndërhyjnë në vendngjarje informacionin, dokumentet dhe ndihmën e nevojshme për identifikimin e mallrave të rrezikshme, vlerësimin e rrezikut dhe marrjen e masave përkatëse.

Neni 61

Raporti i aksidentit ose incidentit

1. Kur ADR-ja ose RID-i kërkon përgatitjen e raportit të aksidentit ose incidentit, pjesëmarrësi që ka detyrimin përkatës sipas ADR-së ose RID-it përgatit raportin në formën, përmbajtjen dhe afatin e parashikuar në ADR ose RID.

2. Raporti i aksidentit ose incidentit i dërgohet strukturës përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme pranë ministrisë përgjegjëse për transportin dhe, sipas rastit, Policisë Rrugore, Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore, Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial, autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese, sigurinë bërthamore ose lëndët plasëse për përdorim civil, ose autoriteteve doganore, sipas natyrës së ngjarjes.

3. Kur ngjarja ka ndodhur në transportin rrugor, hekurudhor ose gjatë veprimtarive të lidhura drejtpërdrejt me transportin, pjesëmarrësit përkatës bashkëpunojnë për përgatitjen e raportit dhe vënien në dispozicion të informacionit të nevojshëm.

Neni 62

Administrimi i të dhënave për aksidentet dhe incidentet

1. Struktura përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme administron të dhënat që i përcillen për aksidentet, incidentet, raportet e përgatitura sipas ADR-së ose RID-it dhe masat e marra nga autoritetet e përcaktuara në nenet 59, 60 dhe 61 të këtij ligji.

2. Ministria përgjegjëse për transportin, mbi bazën e të dhënave të përcjella nga autoritetet kompetente dhe informacionit të përgatitur nga struktura përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme, vlerëson periodikisht zbatimin e këtij ligji, me qëllim identifikimin e nevojës për ndryshime ligjore ose nënligjore. Ky vlerësim mbështetet, sipas rastit, në të dhënat për kontrollet, shkeljet, masat, sanksionet, aksidentet, incidentet, autorizimet, certifikatat dhe trajnimet.

KREU IX

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE, SANKSIONET DHE MASAT ADMINISTRATIVE

Neni 63

Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e parashikuara në këtë nen, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen sipas kategorisë së rrezikut, subjektit përgjegjës dhe masës së gjobës së përcaktuar në këtë nen.

2. Shkeljet e kategorisë së rrezikut I, të kryera nga personi juridik, dënohen si më poshtë:

a) dorëzimi, pranimi, nisja, kryerja ose vijimi i transportit të mallrave të rrezikshme që nuk janë të klasifikuara, identifikuar, të lejuara për transport, të ambalazhuara, të shënuara, të etiketuara ose të dokumentuara sipas kërkesave të këtij ligji, ADR-së ose RID-it, kur kjo krijon rrezik të lartë për jetën, shëndetin, pronën ose mjedisin, sipas nenit 16, pika 2, nenit 17, pika 2, nenit 18, pikat 2 dhe 4, nenit 31, pikat 1, 2 dhe 3, nenit 32, pikat 1, 2 dhe 3, nenit 35, pikat 1, 2, 3 dhe 4, nenit 37, pikat 1, 2 dhe 3, dhe nenit 39, pikat 1 dhe 2, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 750 000 deri në 1 000 000 lekë;

b) kryerja e transportit të lëndëve plasëse, materialeve radioaktive ose materialeve bërthamore pa autorizimin përkatës, me autorizim të pavlefshëm, jashtë afatit të autorizimit ose në kundërshtim me kushtet thelbësore të autorizimit, sipas nenit 41, pikat 1, 2 dhe 3, nenit 43, pikat 3, 4 dhe 5, nenit 44, pika 5, dhe nenit 48, pikat 1 dhe 2, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 750 000 deri në 1 000 000 lekë;

c) përdorimi për transport i ambalazheve, ambalazheve të mëdha, kontejnerëve të ndërmjetëm, cisternave, kontejnerëve-cisternë, cisternave të lëvizshme, vagonëve-cisternë ose pajisjeve të tjera që nuk lejohen për mallrat përkatëse, janë të dëmtuara, paraqesin rrjedhje, nuk janë të miratuara, testuara, inspektuara ose shënuara sipas kërkesave të zbatueshme, kur kjo krijon rrezik të lartë për jetën, shëndetin, pronën ose mjedisin, sipas nenit 31, pikat 1 dhe 3, nenit 32, pikat 1 dhe 2, nenit 33, pika 1, nenit 35, pikat 1, 2, 3 dhe 4, dhe nenit 36, pikat 1 dhe 2, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 750 000 deri në 1 000 000 lekë;

ç) përdorimi për transport i mjetit rrugor, njësisë së transportit, vagonit ose pajisjes tjetër të transportit që nuk përmbush kërkesat teknike, dokumentare, të pajisjes, shënimit, vendosjes së paneleve ose sigurisë, kur kjo krijon rrezik të lartë për jetën, shëndetin, pronën ose mjedisin, sipas nenit 37, pikat 1, 2 dhe 3, nenit 39, pika 2, dhe nenit 40, pikat 1 dhe 2, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 750 000 deri në 1 000 000 lekë;

d) kryerja e transportit rrugor me mjet që duhet të jetë i pajisur me certifikatë miratimi ADR, kur certifikata mungon, është e pavlefshme, ka skaduar ose nuk përputhet me gjendjen faktike të mjetit, sipas nenit 25, pika 3, nenit 37, pikat 1 dhe 2, dhe nenit 39, pikat 1, 2 dhe 4, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 750 000 deri në 1 000 000 lekë;

dh) ngarkimi, vendosja, sigurimi, ndarja, ambalazhimi i përzier, mbushja, shkarkimi, pastrimi ose dekontaminimi i mallrave të rrezikshme në kundërshtim me kërkesat e sigurisë, kur kjo krijon rrezik të lartë për jetën, shëndetin, pronën ose mjedisin, sipas nenit 20, pikat 3, 4 dhe 5, nenit 21, pikat 3, 4, 5, 6 dhe 7, nenit 22, pikat 2, 3, 4 dhe 5, nenit 23, pikat 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9, dhe nenit 24, pikat 2, 3, 4 dhe 6, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 750 000 deri në 1 000 000 lekë;

e) pranimi, nisja ose vijimi i transportit rrugor të mallrave të rrezikshme nga transportuesi, kur drejtuesi i mjetit rrugor nuk zotëron certifikatë të vlefshme trajnimi dhe kjo certifikatë kërkohet sipas ADR-së ose këtij ligji, sipas nenit 18, pikat 2 dhe 4, nenit 25, pika 2, dhe nenit 30, pika 1, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 300 000 deri në 600 000 lekë;

ë) moszbatimi i masës së vendosur nga Policia Rrugore për ndalimin, pezullimin, kufizimin, korrigjimin ose vijimin e kushtëzuar të transportit rrugor të mallrave të rrezikshme, sipas nenit 52, pikat 6, 7 dhe 8, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 750 000 lekë;

f) moszbatimi i masës së vendosur nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore për ndalimin, veçimin, zhvendosjen, mbajtjen e sigurt ose vijimin e kushtëzuar të transportit hekurudhor të mallrave të rrezikshme, sipas nenit 58, pikat 1, 2 dhe 3, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 750 000 deri në 1 000 000 lekë;

g) mosnjohimi i aksidentit, incidentit, derdhjes, rrjedhjes, humbjes së mallrave të rrezikshme ose rrezikut të menjëhershëm, sipas nenit 59, pikat 1, 3 dhe 4, të këtij ligji, kur kjo krijon ose mund të krijojë rrezik të lartë për jetën, shëndetin, pronën ose mjedisin, dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 750 000 lekë;

gj) mospërmblidhja e masave fillestare për kufizimin e pasojave të aksidentit, incidentit, derdhjes, rrjedhjes, humbjes së mallrave të rrezikshme ose rrezikut të menjëhershëm, ose mosdhënia e informacionit dhe ndihmës së nevojshme për autoritetet kompetente dhe strukturat që ndërhyjnë në vendngjarje, sipas nenit 60, pikat 1, 2 dhe 3, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë.

3. Shkeljet e kategorisë së rrezikut II, të kryera nga personi juridik, dënohen si më poshtë:

a) përdorimi për transport i ambalazheve, cisternave, kontejnerëve, mjeteve rrugore, njërive të transportit, vagonëve ose pajisjeve të tjera me mospërputhje teknike, dokumentare, të shënimit, të pajisjes ose të vlefshmërisë, kur mospërputhja nuk krijon rrezik të menjëhershëm, sipas nenit 31, pikat 1, 2 dhe 3, nenit 32, pikat 1 dhe 2, nenit 35, pikat 1, 2, 3 dhe 4, nenit 37, pikat 1, 2 dhe 3, nenit 39, pikat 1, 2 dhe 4, dhe nenit 40, pikat 1 dhe 2, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 750 000 lekë;

b) mosdorëzimi nga dërguesi të transportuesi i dokumenteve të transportit, autorizimeve, miratimeve, njoftimeve ose informacioneve të nevojshme për kryerjen e transportit të mallrave të rrezikshme, sipas nenit 17, pikat 2, 6 dhe 7, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 750 000 lekë;

c) pranimi, nisja, kryerja ose vijimi i transportit nga transportuesi, kur mungojnë dokumentet, autorizimet, shenjat, pajisjet, certifikatat ose kushte të tjera të kërkuara sipas këtij ligji ose ADR-së, por mospërputhja nuk krijon rrezik të menjëhershëm, sipas nenit 18, pikat 2, 3, 4 dhe 5, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 750 000 lekë;

ç) mospërmbushja e detyrimeve të marrësit, ngarkuesit, shkarkuesit, ambalazhuesit, mbushësit ose operatorit të cisternës, kur shkelja krijon rrezik për njerëzit, pronën ose mjedisin, por nuk përbën shkelje të kategorisë së rrezikut I, sipas nenit 19, pikat 2, 3, 4 dhe 5, nenit 20, pikat 2, 3, 4, 5 dhe 6, nenit 21, pikat 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7, nenit 22, pikat 2, 3, 4 dhe 5, nenit 23, pikat 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9, dhe nenit 24, pikat 2, 3, 4, 5 dhe 6, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 750 000 lekë;

d) mosnjoftimi paraprak i autoriteteve kompetente për transportin e lëndëve plasëse, materialeve radioaktive ose materialeve bërthamore, kur ky njoftim kërkohet sipas këtij ligji ose kushteve të autorizimit, sipas nenit 45, pikat 1, 2, 4 dhe 5, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 750 000 lekë;

dh) moszbatimi i kufizimeve ose ndalimeve të posaçme për itinerarin, kohën e transportit, ndalimin, parkimin, kalimin, shoqërimin ose masa të tjera të sigurisë, të vendosura sipas këtij ligji ose kushteve të autorizimit, sipas nenit 43, pikat 2 dhe 5, nenit 44, pika 5, dhe nenit 46, pikat 1, 2 dhe 5, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 750 000 lekë;

e) mospërgatitja ose mosdërgimi i raportit të aksidentit ose incidentit, kur ky raport kërkohet sipas ADR-së, RID-it ose këtij ligji, sipas nenit 61, pikat 1, dhe 2, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 750 000 lekë;

ë) mospërmbushja e detyrimit për caktimin e këshilltarit të sigurisë, caktimi i një personi pa certifikatë të vlefshme ose mosnjoftimi i caktimit apo ndryshimit të tij pranë strukturës përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme, sipas nenit 26, pikat 1, 3, 4, 5 dhe 6, dhe nenit 28, pikat 1 dhe 2, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 750 000 lekë;

f) mospërmbushja e detyrimeve në transportin hekurudhor të mallrave të rrezikshme nga sipërmarrësi hekurudhor, administruesi i infrastrukturës, operatori i impiantit të shërbimit, subjekti përgjegjës për mirëmbajtjen ose pjesëmarrësit e tjerë në transport, kur shkelja lidhet me përputhjen me RID-in ose me masat e vendosura nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore dhe nuk përbën shkelje të kategorisë së rrezikut I, sipas nenit 40, pikat 1 dhe 2, nenit 57, pikat 4 dhe 5, dhe nenit 58, pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 750 000 lekë.

4. Shkeljet e kategorisë së rrezikut III, të kryera nga personi juridik, dënohen si më poshtë:

a) vendosja e shenjave, etiketave, pllakave-etiketa, paneleve portokalli, mbishkrimeve ose shenjave të tjera të rrezikut në një paketë, mjet rrugor, vagon, cisternë ose kontejner që nuk përdoret për transportin e mallrave të rrezikshme, sipas nenit 32, pika 3, nenit 37, pika 2, dhe nenit 40, pika 2, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 300 000 deri në 600 000 lekë;

b) vendosja, përmasa, lexueshmëria ose pozicionimi i pasaktë i shenjave, etiketave, pllakave-etiketa, paneleve portokalli, mbishkrimeve ose shenjave të tjera të rrezikut, kur mospërputhja nuk pengon identifikimin e mallrave të rrezikshme dhe nuk cenon menjëherë sigurinë, sipas nenit 31, pika 2, nenit 32, pikat 2 dhe 3, nenit 35, pika 2, nenit 37, pika 2, dhe nenit 40, pika 2, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 300 000 deri në 600 000 lekë;

c) vendosja ose përdorimi i kodit, markës, shenjës ose të dhënave të miratimit të ambalazhit pa kryer testimin, kontrollin ose miratimin e kërkuar, ose në kundërshtim me tipin e miratuar, sipas nenit 32, pikat 1 dhe 2, dhe nenit 36, pikat 1 dhe 2, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 150 000 deri në 200 000 lekë;

ç) mosplotësimi nga këshilltari i sigurisë i detyrimeve për kryerjen e detyrave të tij, përgatitjen e raportit vjetor, përgatitjen e raportit të aksidentit ose incidentit ose këshillimin e subjektit, sipas nenit 27, pikat 1, 2 dhe 3, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 300 000 deri në 600 000 lekë;

d) angazhimi në detyra të lidhura me transportin e mallrave të rrezikshme i personelit që nuk ka marrë trajnimin e kërkuar sipas detyrës që kryen, sipas nenit 29, pikat 1, 2 dhe 3, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 300 000 deri në 600 000 lekë;

dh) mosparaqitja gjatë kontrollit rrugor e dokumenteve të transportit, autorizimeve, certifikatave ose dokumentit që vërteton rezultatin e kontrollit, sipas nenit 25, pika 3, dhe nenit 51, pika 3, ose mosdhënia e informacionit, dokumenteve dhe aksesit të nevojshëm gjatë kontrollit në mjediset e subjektit, sipas nenit 53, pika 6, të këtij ligji, kur shkelja nuk përbën shkelje të kategorisë së rrezikut I ose II, dënohet me gjobë nga 300 000 deri në 600 000 lekë;

e) mosruajtja ose mosvënia në dispozicion e dokumentacionit, certifikatave, raporteve, të dhënave të trajnimit ose dokumenteve të tjera të kërkuara sipas këtij ligji, sipas nenit 24, pika 5, nenit 27, pika 2, nenit 29, pika 3, dhe nenit 53, pika 6, të këtij ligji, kur shkelja nuk përbën shkelje të kategorisë së rrezikut I ose II, dënohet me gjobë nga 300 000 deri në 600 000 lekë.

5. Shkeljet e mëposhtme, kur kryhen nga person fizik, dënohen si më poshtë:

a) ushtrimi i funksionit të këshilltarit të sigurisë pa certifikatë të vlefshme ose jashtë fushës së vlefshmërisë së certifikatës, sipas nenit 26, pika 3, dhe nenit 28, pikat 1 dhe 2, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 60 000 lekë;

b) mosplotësimi nga drejtuesi i mjetit rrugor i detyrimit për trajnim dhe pajisje me certifikatë të vlefshme trajnimi, kur ajo kërkohet sipas ADR-së, sipas nenit 25, pika 2, dhe nenit 30, pika 1, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 60 000 lekë;

c) mosmbajtja ose mosparaqitja nga drejtuesi i mjetit rrugor e certifikatës së trajnimit të drejtuesit të mjetit sipas ADR-së, dokumenteve të transportit, autorizimeve, certifikatave ose dokumenteve të tjera të kërkuara, sipas nenit 25, pika 3, dhe nenit 51, pika 3, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 60 000 lekë;

ç) mospërmblidhja nga drejtuesi i mjetit rrugor e detyrimeve për zbatimin e udhëzimeve me shkrim, përdorimin e pajisjeve, respektimin e ndalimeve, kufizimeve ose masave të sigurisë, sipas nenit 25, pikat 4, 5 dhe 6, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 60 000 lekë;

d) moszbatimi nga drejtuesi i mjetit rrugor i masës së ndalimit, pezullimit, kufizimit, korrigjimit ose vijimit të kushtëzuar të transportit, sipas nenit 52, pikat 6, 7 dhe 8, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë;

dh) mosdhënia nga personi i përfshirë në transport e informacionit, dokumenteve ose ndihmës së nevojshme për autoritetet kompetente në rast aksidenti, incidenti ose rreziku të menjëhershëm, sipas nenit 60, pika 3, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë.

Neni 64

Masat administrative plotësuese

1. Përveç gjobës, autoriteti që vendos sanksionin ose masën administrative sipas nenit 65 të këtij ligji, sipas fushës së përgjegjësisë dhe brenda kompetencave të përcaktuara në këtë ligj ose në legjislacionin e posaçëm në fuqi, mund të vendosë masa administrative plotësuese për parandalimin, kufizimin ose shmangien e rrezikut që lidhet me transportin e mallrave të rrezikshme.

2. Masat administrative plotësuese që lidhen me transportin, mjetin rrugor, vagonin, cisternën, kontejnerin, ngarkesën, ambalazhin ose pajisjet përfshijnë, sipas rastit:

a) ndalimin e nisjes ose vijimit të transportit;

b) ndalimin, veçimin, zhvendosjen ose mbajtjen e sigurt të mjetit rrugor, vagonit, cisternës, kontejnerit ose ngarkesës;

c) detyrimin për korrigjimin e mospërputhjes, përfshirë sigurimin, transferimin, shkarkimin, rregullimin, pastrimin ose dekontaminimin e ngarkesës;

ç) ndalimin e përdorimit të ambalazhit, cisternës, kontejnerit, vagonit, mjetit rrugor ose pajisjes tjetër deri në korrigjimin e mospërputhjes.

3. Kur shkelja e konstatuar kërkon marrjen e një mase administrative plotësuese ndaj një autorizimi, certifikate, miratimi ose dokumenti të lëshuar ose të administruar sipas këtij ligji, masa

vendoset në varësi të natyrës së shkeljes, shkallës së rrezikut dhe mundësisë së korrigjimit të mospërputhjes, si më poshtë:

a) pezullimi, kur mospërputhja është e korrigjueshme, por vijimi i përdorimit të autorizimit, certifikatës, miratimit ose dokumentit përkatës mund të cenojë sigurinë e transportit deri në korrigjimin e saj;

b) kufizimi i vlefshmërisë, kur autorizimi, certifikata, miratimi ose dokumenti mund të përdoret vetëm për një fushë, afat, mjet, kategori, klasë mallrash ose kushte të caktuara, pa cenuar sigurinë e transportit;

c) revokimi, kur subjekti, drejtuesi i mjetit, mjeti, pajisja ose këshilltari i sigurisë nuk plotëson më kushtet mbi bazën e të cilave është lëshuar autorizimi, certifikata, miratimi ose dokumenti përkatës;

ç) anulimi, kur autorizimi, certifikata, miratimi ose dokumenti është lëshuar mbi bazën e të dhënave, deklarimeve ose dokumenteve të pasakta, të pavërteta ose të pavlefshme, ose në kundërshtim me kushtet e parashikuara për lëshimin e tij.

4. Masat sipas pikës 3 të këtij neni vendosen me vendim të arsyetuar nga autoriteti që shqyrton shkeljen sipas nenit 65 të këtij ligji, në rastet e parashikuara në këtë ligj ose në legjislacionin e posaçëm në fuqi. Këto masa mund të zbatohen, ndër të tjera, ndaj certifikatës së miratimit ADR për mjetin rrugor, certifikatës së trajnimit të drejtuesit të mjetit sipas ADR-së dhe certifikatës së këshilltarit të sigurisë.

Kur masa zbatohet ndaj një dokumenti, certifikate, autorizimi ose miratimi që administrohet nga një autoritet tjetër, autoriteti që ka marrë vendimin ia përcjell atë autoritetit administrues për kryerjen e veprimeve administrative në regjistrat, dokumentet ose sistemet që ka në administrim.

5. Masat administrative plotësuese në transportin rrugor vendosen duke mbajtur parasysh kategorinë e rrezikut të shkeljes dhe masat e parashikuara në nenin 52 të këtij ligji.

6. Për transportin hekurudhor, masat administrative plotësuese vendosen nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore, sipas kompetencave të parashikuara në nenin 65, pika 3, të këtij ligji, dhe në përputhje me masat e parashikuara në nenin 58 të këtij ligji.

Neni 65

Autoritetet kompetente për konstatimin dhe vendosjen e sanksioneve

1. Kundërvajtjet administrative sipas këtij ligji konstatohen dhe sanksionet vendosen nga autoritetet e përcaktuara në këtë nen, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë.

2. Për transportin rrugor të mallrave të rrezikshme, kundërvajtjet që konstatohen gjatë kontrollit rrugor ose në lidhje me masat e vendosura gjatë këtij kontrolli konstatohen dhe sanksionohen nga Policia e Shtetit, nëpërmjet strukturave të Policisë Rrugore.

3. Për transportin hekurudhor të mallrave të rrezikshme, kundërvajtjet që lidhen me sigurinë hekurudhore, zbatimin e RID-it dhe masat e vendosura gjatë kontrollit hekurudhor konstatohen dhe sanksionohen nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore, sipas kompetencave të tij.

4. Kundërvajtjet që lidhen me importimin, eksportimin ose kalimin transit të mallrave të rrezikshme, për aq sa konstatohen gjatë ushtrimit të funksioneve doganore, konstatohen dhe sanksionohen nga autoritetet doganore, sipas legjislacionit doganor dhe këtij ligji.

5. Kundërvajtjet që lidhen me lëndët plasëse për përdorim civil, materialet radioaktive ose materialet bërthamore konstatohen dhe sanksionohen nga autoriteti përgjegjës për lëndët plasëse për përdorim civil, autoritetet përgjegjëse për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese ose autoritetet përgjegjëse për sigurinë bërthamore, sipas rastit dhe legjislacionit të posaçëm në fuqi.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore kryejnë veprimet administrative në regjistrat, dokumentet dhe certifikatat që administrojnë, kur vendimi për pezullimin, revokimin, anulimin ose kufizimin e vlefshmërisë së tyre është marrë nga autoriteti që ka shqyrtuar shkeljen sipas këtij neni.

7. Kur gjatë kontrollit një autoritet konstaton shkelje që i përket fushës së përgjegjësisë së një autoriteti tjetër, ai i përcjell pa vonesë informacionin dhe dokumentacionin përkatës autoritetit përgjegjës sipas këtij neni.

Neni 66

Ankimi dhe ekzekutimi

1. Ndaj vendimit të autoritetit që ka vendosur kundërvajtjen administrative, sanksionin ose masën administrative plotësuese sipas nenit 65 të këtij ligji, kur vendimi merret në kuadër të veprimtarisë inspektuese, bëhet ankimi sipas legjislacionit në fuqi për inspektimin.

2. Ndaj vendimeve të tjera të autoriteteve kompetente, të marra në zbatim të këtij ligji, bëhet ankimi sipas Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionit në fuqi.

3. Gjoha e vendosur në zbatim të nenit 63 të këtij ligji përbën titull ekzekutiv.

4. Gjoha paguhet brenda 15 ditëve kalendarike nga data kur është vendosur dënimi me gjobë.

5. Nëse arkëtimi i vlerës së gjobës bëhet brenda afatit të parashikuar në pikën 4 të këtij neni, gjoha ulet me 50 për qind të vlerës.

6. Për transportuesin me seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kur gjoha vendoset gjatë kontrollit rrugor, largimi i mjetit nga territori i Republikës së Shqipërisë mund të kushtëzohet me pagesën e gjobës ose me depozitimin e një garancie financiare në shumën e gjobës së vendosur, pa cenuar të drejtën e ankimit. Në rast ndryshimi ose shfuqizimi të vendimit, garancia financiare kthehet, plotësisht ose pjesërisht, sipas vendimit përfundimtar.

7. Në rast mosekzekutimi vullnetar, ekzekutimi i gjobës kryhet nga zyra e përmbarimit, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile dhe në legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

8. Të ardhurat e grumbulluara nga gjobat derdhen në buxhetin e shtetit.

KREU X

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 67

Komunikimi me Komisionin Evropian

1. Pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ministria përgjegjëse për transportin kryen komunikimin zyrtar me Komisionin Evropian në rastet kur ky ligj ose legjislacioni i Bashkimit Evropian kërkon njoftim, arsyetim, raportim, kërkesë për autorizim ose kërkesë për zgjatje të autorizimit.

2. Ministria përgjegjëse për transportin njofton Komisionin Evropian, duke paraqitur edhe arsyetimin përkatës, për:

a) moszbatimin e kërkesave për transportin e mallrave të rrezikshme në rrugë ujore të brendshme, në lidhje me nenin 3, pika 4, të këtij ligji, për shkaqet e mëposhtme:

i) rrugët ujore të brendshme të Republikës së Shqipërisë nuk janë të lidhura, nëpërmjet rrugëve ujore të brendshme, me rrugët ujore të brendshme të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian; ose

ii) në rrugët ujore të brendshme të Republikës së Shqipërisë nuk kryhet transport i mallrave të rrezikshme;

b) kërkesat specifike të sigurisë me karakter të përgjithshëm, kur këto kërkesa vendosen sipas nenit 46, pikat 1 dhe 2, të këtij ligji dhe lidhen me përdorimin e itinerareve të përcaktuara, mënyrave të përcaktuara të transportit ose rregullave të posaçme për transportin e mallrave të rrezikshme në trena pasagjerësh;

c) masat që propozohen të merren, në fazën e planifikimit, pas një aksidenti ose incidenti në territorin e Republikës së Shqipërisë, kur dispozitat e sigurisë të zbatueshme sipas këtij ligji, ADR-së ose RID-it vlerësohen të pamjaftueshme për të kufizuar rreziqet e përfshira në operacionet e transportit dhe ekziston nevojë urgjente për veprim.

3. Pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ministria përgjegjëse për transportin i kërkon Komisionit Evropian autorizimin ose zgjatjen e autorizimit të përjashtimeve me karakter të përgjithshëm nga ADR-ja ose RID-i, në rastet e parashikuara në nenin 47, pika 10, të këtij ligji.

4. Masat e propozuara sipas pikës 2, shkronja “c”, të këtij neni dhe përjashtimet me karakter të përgjithshëm sipas pikës 3 të këtij neni zbatohen vetëm pas autorizimit nga Komisioni Evropian dhe

për afatin e përcaktuar në vendimin përkatës të autorizimit. Përjashtimet me karakter të përgjithshëm sipas pikës 3 të këtij neni nuk mund të autorizohen për një afat më të gjatë se gjashtë vjet nga data e autorizimit dhe zbatohen pa diskriminim.

5. Kërkesa për zgjatjen e autorizimit të një përjashtimi me karakter të përgjithshëm sipas pikës 3 të këtij neni paraqitet nga ministria përgjegjëse për transportin pranë Komisionit Evropian përpara përfundimit të afatit të autorizimit në fuqi. Zgjatja zbatohet vetëm pas autorizimit nga Komisioni Evropian dhe për afatin e përcaktuar në vendimin përkatës.

6. Autoritetet e përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji dhe struktura përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme i përcjellin ministrisë përgjegjëse për transportin informacionin, të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm për njoftimet, raportimet, kërkesat dhe komunikimet sipas pikave 2, 3 dhe 5 të këtij neni.

7. Pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ministria përgjegjëse për transportin i komunikon Komisionit Evropian tekstin e dispozitave kryesore të legjislacionit kombëtar të miratuara në fushën e rregulluar nga ky ligj.

Neni 68

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të nenit 30, pika 6, nenit 38, pika 7, nenit 39, pika 5, nenit 48, pika 6, dhe nenit 49, pika 8, të këtij ligji.

Neni 69

Vazhdimi i efekteve të disa akteve nënligjore dhe dokumenteve të lëshuara

1. Aktet nënligjore të mëposhtme, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe për aq sa nuk bien ndesh me këtë ligj, ADR-në ose RID-in, mbeten në fuqi dhe zbatohen deri në miratimin e akteve të reja nënligjore në zbatim të këtij ligji:

a) udhëzimi nr. 3985/4, datë 24.6.2013, “Mbi procedurat e kontrollit në transportin rrugor të mallrave të rrezikshme”;

b) udhëzimi nr. 6, datë 27.5.2015, “Për procedurat e inspektimit të mjeteve, lëshimit të certifikatës së miratimit ADR, kushtet që duhet të plotësojë personi juridik për inspektimin e mjeteve ADR dhe tarifat e shërbimit”;

c) udhëzimi nr. 4, datë 3.2.2022, “Për programin, trajnimin, testimin dhe lëshimin e certifikatës për drejtuesit e mjeteve, që kryejnë transportin e mallrave të rrezikshme dhe tarifat përkatëse”, të ndryshuar;

ç) udhëzimi nr. 5, datë 3.2.2022, “Për programin, trajnimin, testimin dhe lëshimin e certifikatës për këshilltarët e sigurisë në transportin e mallrave të rrezikshme dhe tarifat përkatëse”, të ndryshuar.

2. Autorizimet, certifikatat, miratimet dhe dokumentet e tjera të lëshuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji mbeten të vlefshme deri në përfundimin e afatit për të cilin janë lëshuar, përveç rasteve kur pezullohen, revokohen ose anulohen sipas këtij ligji ose legjislacionit të posaçëm në fuqi.

3. Subjektet që ushtrojnë veprimtari të lidhura me transportin e mallrave të rrezikshme përshtatin veprimtarinë e tyre me kërkesat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij brenda afateve të përcaktuara në aktet përkatëse.

Neni 70

Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 118/2012, datë 13.12.2012, “Për transportin e mallrave të rrezikshme”, vendimi nr. 266, datë 7.5.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e funksionimit dhe të detyrave të Komitetit Ndërmnistror për Transportin e Mallrave të Rrezikshme”, si dhe çdo akt tjetër nënligjor që bie në kundërshtim me këtë ligj, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 69 të këtij ligji, shfuqizohen.

Neni 71
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

Miraturar në datën __.__.2026.

K R Y E T A R I

NIKO PELESHI